



ÇFARË ËSHTË DITA E GADIJRIT

Përgatiti: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Tiranë, 2026

Titulli: Çfarë është Dita e Gadijrit

Përgatitur nga: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

E redaktoi: Zahraa MERJA

E korrektoi: Ma. Isra MERJA

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie FEZA

Kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: Shoqata “Flladi” - Tiranë, 2026

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit!

HYRJE

Në historinë e Islamit ka ngjarje që nuk mbeten vetëm pjesë e së kaluarës, por vazhdojnë të ndriçojnë rrugën e besimtarëve në çdo kohë. Ato janë momente vendimtare që kanë formësuar identitetin, besimin dhe orientimin e umetit islam. Njëra prej këtyre ngjarjeve madhështore është Dita e Gadijr Khummit, një ditë që zë një vend të veçantë në ndërgjegjen e myslimanëve dhe që lidhet drejtpërdrejt me çështjen e udhëheqjes së bashkësisë islame pas Profetit Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij).

Ngjarja e Gadijr Khummit ndodhi në vitin e dhjetë pas Hixhretit, gjatë kthimit të Profetit nga Haxhi i Lamtumirës. Në një vend të quajtur Gadijr Khumm, mes Mekës dhe Medinës, Profeti ndaloi karvanin e madh të haxhinjve dhe mbajti një fjalim para mijëra besimtarëve të mbledhur. Burime të shumta historike dhe hadithore, si shiite ashtu edhe sunite, e kanë transmetuar këtë ngjarje, e cila konsiderohet ndër ngjarjet më të dokumentuara të historisë islame.

Në këtë tubim historik, Profeti ngriti dorën e imam Ali ibn Ebi Talibit (Paqja qoftë mbi të!) dhe shpalli fjalët e njohura: “Për këdo që unë jam udhëheqësi i tij, Aliu është udhëheqësi i tij.” Ky deklaram ka zënë një vend qendror në mendimin islam dhe është interpretuar në mënyra të ndryshme përgjatë historisë. Për shkollën e Ehli Bejtit, ai përfaqëson shpalljen publike të udhëheqjes dhe trashëgimisë shpirtërore e shoqërore të imam Aliut pas Profetit, ndërsa në traditën sunite ngjarja pranohet si autentike, megjithëse kuptimi i saj interpretohet ndryshe.

Megjithatë, Gadijri nuk është thjesht një debat historik mbi një ngjarje të së kaluarës. Ai përfaqëson një mesazh të përhershëm mbi rëndësinë e udhëzimit të Allahut, vazhdimësinë e misionit profetik dhe nevojën e njerëzimit për udhëheqës të drejtë e të pastër. Në këtë kuptim, Gadijri është një urë që lidh profecinë me imametin,

shpalljen hyjnore me udhëheqjen e umetit dhe fenë me përgjegjësinë për ta ruajtur atë të pastër nga devijimet.

Për besimtarët që ndjekin shkollën e Ehli Bejtit, Dita e Gadijrit është një festë e madhe fetare, e njohur si “Eidul Gadijr”, një ditë falënderimi ndaj Allahut për plotësimin e fesë dhe përsosjen e mirësisë së Tij ndaj njerëzimit. Ajo kujton jo vetëm një ngjarje historike, por edhe një besëlidhje shpirtërore për besnikëri ndaj së vërtetës, drejtësisë dhe udhëheqjes së caktuar nga Allahu i Madhëruar.

Me rastin e festës së madhe të Gadijrit, Shoqata “Flladi” e ka zbukuruar bibliotekën e saj me librin: **“ÇFARË ËSHTË DITA E GADIJRIT?** Libri është përgatitur nga Kryetari i Shoqatës “FLLADI” **Haxhi Shenjkh Vullnet MERJA.**

Qëllimi i këtij libri është të paraqesë në mënyrë të qartë dhe të argumentuar realitetin e Ditës së Gadijr Khummit, vendin e saj në historinë islame, dëshmitë kuranore dhe hadithore që lidhen me të, si dhe mesazhet e shumta që kjo ngjarje bart për myslimanët e çdo epoke. Lexuesi do të njihet me rrethanat e ngjarjes, tekstet kryesore të transmetuara, qëndrimet e dijetarëve dhe ndikimin që Gadijri ka pasur në historinë dhe mendimin islam.

Në një kohë kur shumë njerëz kërkojnë të kuptojnë më thellë rrënjët e besimit të tyre, rikthimi te Gadijri nuk është vetëm një studim historik; ai është një ftesë për të

reflektuar mbi rëndësinë e udhëzimit hyjnor, mbi përgjegjësinë ndaj së vërtetës dhe mbi rolin e prijësve të zgjedhur nga Allahu në ruajtjen e mesazhit profetik. Prandaj, njohja e Gadijrit është një hap drejt njohjes më të thellë të Islamit dhe të misionit të tij universal.

Lusim Allahun e Madhëruar që ky libër të jetë një kontribut modest në njohjen e kësaj ngjarjeje madhështore dhe një mjet për afrimin e zemrave me të vërtetën, dashurinë ndaj Profetit dhe familjes së tij të pastër, dhe me rrugën e drejtë që Allahu ka zgjedhur për robtë e Tij.

Haxhi Shenjkh Vullnet MERJA

Çfarë është Dita e Gadijrit?

Dita e Gadijrit është dita e tetëmbëdhjetë e muajit Dhul Hixhxheh të vitit të dhjetë pas Hixhretit të bekuar të Profetit.

Ajo është dita në të cilën i Dërguari i zgjedhur i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), me urdhrin e Allahut të Madhëruar, e emëroi imam Ali ibn Ebi Talibin (Paqja qoftë mbi të!) si pasardhës, kujdestar, imam dhe udhëheqës pas tij.

Kjo është një ditë madhështore, dhe hadithet e nderuara kanë përmendur disa aspekte të madhështisë së saj.

Në një transmetim, imam Ali ibn Musa Err Rida (Paqja qoftë mbi të!), nga babai i tij e nga gjyshi i tij, ka thënë: *“Vërtet, Dita e Gadijrit është më e njohur në qiell sesa në tokë.”*¹

¹ “Uesailu Shi’ah” (Tafsil Uesailu Shia ila Tahsil Mesail Esh-Sheri’a), vëll. 14, f. 388, i Shejkh Muhamed ibn Hasan ibn Ali El Hurr El Amilij, i lindur në vitin 1033 hixhri në Xhebel Amil të Libanit dhe ka ndërruar jetë në vitin 1104 hixhri në Mashhad pranë imam Rizait (Paqja qoftë mbi të!), ku edhe është varrosur. Botim i Fondacionit Ehli Bejt, viti 1409 hixhri, Kum, Iran.

Imam Xha'ferr ibn Muhamed Sadik (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *"Emri i saj (Ditës së Gadijrit) në qiell është 'Dita e Besëlidhjes së Premtuar', kurse në tokë është 'Dita e Besës së Marrë' dhe 'Tubimi i Dëshmuar'."*²

Kurse, imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *"Pasha Allahun, sikur njerëzit ta njihnin vlerën e kësaj dite ashtu siç është në të vërtetë, engjëjt do t'i përshëndesnin ata me dorë dhjetë herë në ditë."*³

Kjo ditë konsiderohet ngjarja e dytë më e rëndësishme në Islam pas shpalljes profetike (Bi'thetu) dhe zbritjes së Kur'anit të Shenjtë.

² ("Tehdhijbul-Ahkam", vëll. 3, f. 143, i Shejkh Ebu Xha'ferr Muhamed ibn Hasan Et Tusij, i lindur në Khorasan në vitin 385 hixhri dhe ka ndërruar jetë në Nexhefin e Nderuar në vitin 460 hixhri. Botim i Darul Kutubil Islamijje, viti 1365 hixhri-shemsi (sipas kalendarit iranian), Teheran, Iran.

³ "Uesailu Shi'ah", vëll. 14, f. 389.

Festa e Gadijrit

Dita e Gadijrit është ditë feste; madje ajo është festa më e madhe dhe më fisnike ndër të gjitha festat.⁴

Ajo është Festa më e Madhe e Allahut.⁵

Allahu i Madhëruar nuk ka dërguar asnjë profet, veçse ai e ka kremtuar këtë ditë.⁶

Kjo sepse ajo është dita e përsosjes së fesë dhe e plotësimit të mirësisë të bekuara të Allahut.

Është transmetuar nga imam Xha'ferr ibn Muhamed Es Sadik (Paqja qoftë mbi të!), nga babai i tij dhe nga etërit e tij (Paqja qoftë mbi ta!) se kanë thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"Dita e Gadijrit është festa më e vlefshme e umetit tim. Ajo është dita në të cilën Allahu i Madhëruar më urdhëroi ta caktoj vëllanë tim, Ali ibn Ebi Talibin (Paqja qoftë mbi të!), si prijës dhe shenjë udhëzuese për umetin tim, që ata të udhëzohen me të pas meje. Ajo është dita në të cilën Allahu e përsosi fenë, e plotësoi mirësinë e Tij ndaj umetit tim dhe u kënaq që Islami të jetë feja e tyre..."*⁷

⁴ "Uesailu Shi'ah", vëll. 10, f. 443.

⁵ "Tehdhijbul Ahkam", vëll. 3, f. 143.

⁶ "Tehdhijbul Ahkam", vëll. 3, f. 143.

⁷ "El Emalij, f. 125, i Shejkh Ebu Xha'ferr Muhamed ibn Ali ibn Husejn ibn Babeujh El Kummij, i njohur si Shejkh Saduk, i lindur në vitin 305

Arsyeja e emërimit me emrin “Gadijr”

Kjo ditë është quajtur me këtë emër për shkak se i Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), me urdhrin e Allahut të Madhëruar, u mbloodh në këtë ditë me dhjetëra mijëra prej sahabëve të tij gjatë kthimit nga Haxhi i Lamtumirës, në një vend midis Mekës dhe Medinës që quhej Gadijr Kumm. Për këtë arsye, dita mori emrin e atij vendi dhe u quajt Dita e Gadijrit.

Pse Dita e Gadijrit u bë festë?

Festa është çdo ditë që i bashkon njerëzit në përgjithësi. Origjina e fjalës “*el ‘ijdu*” vjen nga kthimi dhe përsëritja, sepse ajo rikthehet çdo vit. Është thënë, gjithashtu, se do të thotë dita në të cilën rikthehen gëzimi dhe lumturia.

Por, Islami i sheh festat me një këndvështrim të veçantë. Ai i konsideron ato si një mundësi për një tubim të madh besimtarësh, me qëllim përkujtimin e Allahut, ringjalljen e traditave të fesë, përmendjen e Tij dhe drejtimin ndaj Tij me lutje e përgjërim.

hixhri në Kum dhe ka ndërruar jetë në vitin 381 hixhri. Botimi i gjashtë, viti 1418 hixhri, Teheran, Iran.

Është transmetuar nga Imam Ali ibn Musa Err Rida (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Dita e Fitër Bajramit është bërë festë që të jetë për muslimanët një tubim, ku ata mblidhen, dalin përpara Allahut të Madhëruar, e madhërojnë Atë për mirësitë që ua ka dhuruar. Kështu ajo bëhet ditë feste dhe ditë tubimi...”⁸

Prandaj, dita e festës është një ditë falënderimi për begatitë që Allahu na ka dhuruar. Është një ditë gëzimi dhe hareje për besimtarët, sepse ata mblidhen në bindje ndaj Allahut, në kërkimin e kënaqësisë së Tij, në përmendjen dhe adhurimin e Tij.

⁸ “Men La Jehdheruhul Fakijh, vëll. 1, f. 522, i Shejkhut Muhamed ibn Ali ibn Husejn ibn Babeuejh El Kummi, i njohur si Shejh Saduku. Ai lindi në Kum në vitin 305 hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 381 hixhri. Botim i Xhema’tul Muderrisij Publications, i lidhur me Shoqatën e Mësuesve të Hauzës Shkencore, botimi i dytë, viti 1413 hixhri, Qom, Iran.

Festa e Gadijrit – Dita e Plotësimit të fesë dhe e përmbushjes së mirësisë

Allahu i Madhëruar e plotësoi fenë e Tij dhe e përmbushi mirësinë e Tij ndaj besimtarëve duke emëruar Ali ibn Abi Talibin si prijës (khalife), trashëgimtar (uesij) dhe imam pas Profetit Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në ditën e Gadijr Khummit.

Prandaj, kjo është një festë madhështore, madje një nga festat më të mëdha, sepse është dita e plotësimit të fesë dhe e përmbushjes së mirësisë hyjnore.

E çfarë mirësie mund të jetë më e madhe sesa plotësimi i fesë dhe përmbushja e dhuntisë së Allahut? Kjo mirësi meriton falënderim, lavdërim dhe madhërim të Allahut të Lartësuar nga ana e besimtarëve për atë që Ai u ka dhuruar në këtë ditë të bekuar.

Është transmetuar nga El Muvaffak ibn Ahmed El Khauarizmi (ka vdekur në vitin 568 hixhri), me zinxhirin e tij të transmetimit nga Ebu Sa'id El Khudri, i cili ka thënë: Kur i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i thirri njerëzit drejt Aliut në Gadijr Khum dhe urdhëroi që të pastrohej vendi nën pemë nga ferrat, dhe kjo ndodhi ditën e enjte, ai e thirri Aliun dhe e kapi për krahët e tij, duke i ngritur aq lart sa njerëzit panë bardhësinë

e sqetullave të të Dërguarit të Allahut. Njerëzit ende nuk ishin shpërndarë kur zbriti ky ajet:

﴿... الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا ...﴾

“... Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova mbi ju mirësinë Time dhe zgjodha për ju Islamin si fe ...”⁹

Atëherë i Dërguari i Allahut tha: *“Allahu Ekber për plotësimin e fesë, përmbushjen e mirësisë dhe për kënaqësinë e Zotit me shpalljen time dhe me udhëheqësinë (vilajetin) e Aliut pas meje.”*¹⁰

Gjithashtu, Ibn Asakir (i cili vdekur në vitin 571 hixhri) transmeton me zinxhirin e tij nga Ebu Hurejra, i cili ka thënë: Kush agjëron ditën e tetëmbëdhjetë të Dhul Hixhes, i shkruhet shpërblimi i agjërit të gjashtëdhjetë muajve. Ajo është dita e Gadijrj Kummit, kur Profeti e kapi Aliun për dore dhe tha: *“A nuk jam unë më përparësor ndaj besimtarëve?”*

Ata thanë: ‘Po, o i Dërguari i Allahut.’

Atëherë ai (Profeti). tha: *“Për atë që unë jam udhëheqës (meula), Aliu është udhëheqësi i tij.”*

⁹ Sure “El-Maide”, ajeti 3.

¹⁰ “Menakib Ali ibn Ebi Talib”, f. 135. Botim: Kum, Iran.

Atëherë Omar ibn Khattabi tha: 'Urime, urime për ty, o biri i Ebu Talibit! U bërë udhëheqësi im dhe udhëheqësi i çdo muslimani.'

Pas kësaj, Allahu zbriti ajetin:

﴿... الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ ...﴾

"... Sot jua përsosa fenë tuaj dhe e plotësova mbi ju mirësinë Time ..." ^{11 12}

¹¹ Sure "El Maide", ajeti 3.

¹² "Tarijkh Ibn Asakir" (Historia e Ibn Asakirit), Biografia e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), vëll. 2, f. 78. Botim i Darul Fikr, Beirut.

Festa e Gadijrit – Festa më e madhe dhe më e nderuar

Është transmetuar se Hasan ibn Rashid i ka thënë imam Xha'ferr Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): 'U bëfsha flijim për ty! A kanë muslimanët ndonjë festë tjetër përveç dy festave (Fitër Bajramit dhe Kurban Bajramit)?'

Imami tha: *"Po, o Hasan! Ka një festë që është më e madhja dhe më e nderuara prej tyre."*

I thashë: 'Cila ditë është ajo?'

Ai tha: *"Është dita në të cilën Prijësi i besimtarëve, Aliu (Paqja qoftë mbi të!), u vendos si shenjë dhe prijës për njerëzit."*

I thashë: 'U bëfsha flijim për ty! Çfarë duhet të bëjmë në atë ditë?'

Ai tha: *"Agjëroje atë ditë, o Hasan! Shto salavatet mbi Muhamedin dhe Familjen e tij, dhe shpreh para Allahut distancimin tënd nga ata që u bënë padrejtësi atyre. Vërtet, profetët (Paqja qoftë mbi ta!) i urdhëronin trashëgimtarët e tyre që dita në të cilën caktohej trashëgimtari (vesiu) të merrej si festë."*

Hasani thotë: E pyeta: 'Çfarë shpërblimi ka ai që e agjëron këtë ditë?'

Imami tha: *“Shpërblimi i agjërimit të saj është sa agjërimi i gjashtëdhjetë muajve...”*¹³

Ky hadith tregon madhështinë e Ditës së Gadijrit, pasi imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) e përshkruan atë si festën më të madhe dhe më të nderuar të muslimanëve, sepse në të u shpall publikisht vilajeti dhe udhëheqja e Ali ibn Abi Talib pas të Dërguarit të Allahut, Profetit Muhamed (Paqja e bekimet qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Është transmetuar nga Xha’ferr ibn Muhamed Es Sadik (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: *“Festa më e madhe dhe më e nderuar është dita e tetëmbëdhjetë e muajit Dhul-Hixhe. Ajo është dita në të cilën i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij) e ngriti Prijësin e besimtarëve, Aliun (Paqja qoftë mbi të!) dhe e caktoi atë si prijës dhe shenjë udhëzimi për njerëzit.”*

Transmetuesi thotë: E pyeta: ‘Çfarë detyre kemi ne në atë ditë?’

Imami tha: *“Duhet ta agjëroni atë ditë si falënderim dhe lavdërim ndaj Allahut, ndonëse Ai meriton të falënderohet në çdo*

¹³ “El-Kafij”, vëll. 4, f. 148, i Shejkhut Muhamed ibn Ja’kub El Kulejni, i njohur me titullin “Thikatul-Islam” (Besniku i Islamit), i cili ka ndërruar jetë në vitin 329 hixhri. Botim i Darul Kutub El Islamijeh, viti 1365 hixhri-shemsi, Tehran, Iran.

çast. Kush e agjëron atë ditë, shpërblimi i tij është më i madh se sa vepra e gjashtëdhjetë viteve.”¹⁴

Është transmetuar nga Ali ibn Musa Err Rida (Paqja qoftë mbi të!), se ka shpjeguar madhështinë e kësaj dite duke thënë: *“Vërtet, Dita e Gadijrit është më e njohur dhe më e famshme në qiell sesa në tokë... Betohe në Allahun, sikur njerëzit ta njihnin vlerën e kësaj dite ashtu siç është në të vërtetë, engjëjt do t’i përshëndesnin ata me duar (do t’u jepnin selam) dhjetë herë çdo ditë.”¹⁵*

¹⁴ “Uesailu Esh Shi’ah (Tefsilu Uesailu Esh Shi’ah ila Tahsili Mesaili Esh Sheri’ah), vëll. 10, f. 443, i Muhammad ibn al-Hasan al-Hurr al-Amili, i lindur në vitin 1033 hixhri në Xhebel Amil (Liban) dhe i ndarë nga jeta në vitin 1104 hixhri në Mashhad, pranë varrit të Ali ibn Musa al-Rida, ku edhe është varrosur. Botim i Muassasat Alel Bejt, viti 1409 hixhri, Kum.

¹⁵ Tehdhijbul Ahkam”, vëll. 6, f. 25, i Shejkhut Muhamed ibn El Hasan Et Tusij, i njohur si Shejkh Et Taifeh, i lindur në Khorasan në vitin 385 hixhri dhe i ndarë nga jeta në Nexhef në vitin 460 hixhri. Botim i Darul Kutubil Islamiyeh, viti 1365 hixhri-shamsi, Tehran, Iran.

Nuk ka justifikim për askënd

Ngjarja që ndodhi në ditën e Gadijr Khummit ndryshoi rrjedhën e historisë dhe mbi të mbështetet besimi në udhëheqësinë (vilajetin) e imam Ali ibn Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!) pas të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), si dhe në pasardhësinë dhe trashëgiminë e tij në udhëheqje.

Prandaj, pas kësaj dite nuk mbetet asnjë justifikim për askënd. Shejkh Saduku ka thënë: “Dita e Gadijr Khumit nuk i la askujt asnjë arsyetim (justifikim). Kështu ka thënë Zonja e Grave, Fatimeja (paqja qoftë mbi të), kur iu mohua Fedeku dhe ajo iu drejtua ensarëve. Ata i thanë: ‘O bija e Muhamedit! Sikur t’i kishim dëgjuar këto fjalë prej teje para se t’i jepnim besën Ebu Bekrit, nuk do ta kishim barazuar askënd me Aliun.’ Atëherë ajo tha: *“A mos vallë babai im la ndonjë justifikim për dikë në ditën e Gadijr Humit?”*”¹⁶

Gjithashtu, janë transmetuar lutje të veçanta për këtë ditë, të cilat përmbajnë madhërimin, lavdërimin, njësimin dhe falënderimin e Allahut.

Në këtë shqyrtim rreth Hadithit të Gadijr Khumit u bë e qartë se umeti islam është i bashkuar në transmetimin e tij, në vërtetësimin e tij dhe në pohimin e transmetimit të

¹⁶ “El Khisal”, i Shejkh Sadukut, f. 173.

tij të shumëfishtë (teuaturit) nga dijetarët e mëdhenj. Madje, ata janë angazhuar edhe në kundërshtimin e atyre që e kanë mohuar ose kanë hedhur dyshime mbi të. Për të dhe për zinxhirët e transmetimit dhe rrugët e tij janë shkruar dhjetëra vepra, si nga dijetarët sunitë ashtu edhe nga ata shiitë.

Krahasimi ndërmjet Shkollës së Ehli Bejtit, nga njëra anë, dhe Shkollës së Khalifëve, nga ana tjetër, në këtë çështje, tregon se e vërteta, edhe nëse mbetet e fshehur për një periudhë kohe, nuk humbet kurrë. Më në fund, pluhuri largohet prej saj dhe e vërteta kthehet në vendin e saj për këdo që e kërkon sinqerisht.

Hadithi i Gadijrit dhe zbulimi i të vërtetave të ndritshme që përmban ai, është ndër faktorët që bashkojnë umetin, forcojnë radhët e tij dhe përgatisin shkaqet e fitores së tij. Ashtu siç ka thënë Zonja e Grave, Fatimeja (Paqja qoftë mbi të!): *“A mos vallë babai im la ndonjë justifikim për dikë në ditën e Gadijrit Khummit?”*¹⁷

¹⁷ “El Khisal”, i Shejkh Sadukut, f. 173.

Festa e gadijrit në Islam¹⁸

Ndër gjërat që e bënë të pavdekshëm dhe të përhapur hadithin e Gadijrit, dhe që e bënë kuptimin e tij të besueshëm dhe të qëndrueshëm, ishte fakti se kjo ditë u bë një festë (Bajram), e cila festohet me adhurim dhe përulësisë gjatë natës së saj, me kryerjen e veprave të mira, ndihmën ndaj të dobëtëve, gëzimin e vetvetes dhe të familjeve, si dhe me veshjen e rrobave të bukura dhe zbukurimin gjatë ditës së saj.

Kur një shtresë fetare e popullit anon drejt këtyre shfaqjeve, atëherë në mënyrë të natyrshme ajo shtresë do të nxitet të kërkojë burimin dhe shkakun e kësaj ndodhie dhe të qëndrojë e fortë në çështjet e saj, duke hetuar për transmetuesit e saj.

Ose, edhe përputhja e rrethanave me këto cilësi do ta shtyjë njeriun të kërkojë ata që i transmetojnë dhe i rrëfejnë, dhe kështu çdo vit, në çdo epokë dhe për çdo brez, kjo ngjarje do të rikujtohet dhe rifreskohet, zinxhiri i transmetimit do të qëndrojë i pandërprerë, rrugët e

¹⁸ Sheikh Abdul Husejn El Emijni. Marrë nga:
<https://www.islam4u.com/ar/maghalat>

transmetimit do të ruhen, tekstet do të lexohen dhe lajmet për të do të përsëriten vazhdimisht.

Ajo që i shfaqet studiuesit lidhur me festimin të ditës së Gadijrit janë dy çështje:

Çështja e parë:

Kjo festë nuk ka lidhje vetëm me shiitët, edhe pse ata kanë një lidhje të veçantë me të, por në festimin e saj kanë marrë pjesë edhe grupe të tjera nga radhët e myslimanëve.

El Biruni e përmend festën e Gadijrit në librin e tij *“El Asar El Bakiye an El Kurun El Khalijeh”*, f. 334, duke e përfshirë ndër festat që i kanë përdorur ithtarët e Islamit.

Ndërsa Ibn Talha Esh Shafi’ij në librin e tij *“Metalib Es Su’ul”*, f. 53, shkruan: ‘Dita e Gadijr Khumit është përmendur në poezinë e (Imamit) Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe ajo është bërë një ditë feste dhe sezoni, ngase ishte koha kur i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) e emëroi atë (Aliun) në këtë pozitë të lartë dhe e nderoi me këtë pozitë para të gjithë njerëzve.’

Ndërsa në faqen 56 të të njëjtit libër thotë: ‘Çdo kuptim që mund të vërtetohet për fjalën ‘meula’ (udhëheqës) të thënë nga Profeti (Paqja qoftë mbi të dhe

familjen e tij!) i është dhënë Aliut, dhe ajo është një shkallë madhështore, një pozitë e lartë dhe një vend i nderuar, të cilin ai (Aliu) e ka pasur në mënyrë të veçantë para të tjerëve. Për këtë arsye ajo ditë u bë ditë feste dhe gëzimi për miqtë e tij.’

Nga ky pohim përfitojmë se të gjithë myslimanët kanë marrë pjesë në festimin e asaj dite, pavarësisht nëse përemri në fjalën “udhëheqës i tij” i referohet Profetit apo Imam Aliut (Paqja qoftë mbi ta!). Dhe nëse i referohet të parit (Profetit), kjo është e qartë.

Ndërsa nëse përemri (te “udhëheqës i tij”) i referohet të dytit (Aliut), atëherë të gjithë myslimanët e duan dhe e mbështesin Prijësin e besimtarëve, Aliun, sipas parimeve të fesë islame, pa dallim nëse dikush e pranon si khalif të menjëhershëm pas Profetit, apo si të katërtin nga khalifët. Nuk do të gjesh ndër myslimanët askënd që të ushqejë armiqësi ndaj tij, përveç disa të rrallëve nga khaiarixhët, të cilët kanë devijuar nga feja e drejtë islame.

Librat e historisë na mësojnë leksione të rëndësishme rreth kësaj feste dhe për pajtimin e umetit islam rreth saj, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Po ashtu, tregojnë për kujdesin që egjiptianët, marokienët dhe irakianët kanë pasur për këtë ditë në shekujt e mëparshëm, duke e konsideruar një ditë të dalluar për falje, lutje, hytbe (ligjëratë) dhe recitim poezish, siç është përmendur gjerësisht në fjalorët historikë.

Gjithashtu, në disa vende në veprën “*El Uefajat*” të Ibn Khalikanit, duket qartë se ka pasur një konsensus për ta quajtur këtë ditë “festë”.

Në biografinë e *El Musta’la ibn El Mustansir*, vëll. 1, f. 60, ai shkruan: ‘Atij iu dha besa (u zgjodh khalif) në ditën e festës së Gadijr Khumit, që është më 18 Dhul Hixhe, në vitin 487 hixhri.’

Dhe në biografinë e *El Mustansir Bil’lah El Ubejdij*, vëll. 2, f. 223, shkruan: ‘Ai ndërroi jetë natën e së enjtes, më 12 netë të mbetura nga muaji Dhul Hixhe, në vitin 487 hixhri (Allahu e mëshiroftë!). Unë (thotë autori) them: Kjo natë është nata e festës së Gadijrit, pra nata e 18 Dhul Hixhes, dhe ky është Gadijr Khummi, me dhamëz në ‘kha’ dhe me dy mim-e të theksuara. Kam parë shumë njerëz që pyesnin për këtë natë se në cilën ditë të Dhul Hixhes është.’

Ky vend ndodhet mes Mekës dhe Medinës, dhe aty gjendet një pellg uji (Gadijr), dhe thuhet se është një pyll aty pranë.

Kur Profeti (Paqja qoftë mbi të!) u kthye nga Meka (Allahu e nderoftë!) gjatë Haxhit të Lamtumirës dhe arriti në këtë vend, ai bëri vëllazërim me Ali ibn Ebi Talibin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) dhe tha “*Aliu është prej meje sikurse Haruni ishte prej Musait. O Allah, bëhu mik me atë që është mik me të, dhe bëhu armik me atë që është armik i tij. Ndihmoje atë që e ndihmon dhe poshtëroje atë që e poshtëron.*”

Shiitët kanë një lidhje të madhe me këtë ditë. El Khazimi thotë: 'Ajo (Gadijr Khummi) është një luginë mes Mekës dhe Medinës, pranë vendit të quajtur Xhuhfe, ku ndodhet një pellg (Gadijr), pranë të cilit Profeti (Paqja qoftë mbi të!) mbajti një hytbe (fjalim). Kjo luginë përshkruhet me ajër të rëndë dhe vapë të fortë."

Ajo që përmend Ibn Khallikani për lidhjen e madhe të shiitëve me këtë ditë është pikërisht ajo që ka për qëllim edhe El Mes'udi në librin "*Et Tenbih uel ishraf*", f. 221, pas përmendjes së hadithit të Gadijrit, ku thotë: "Pasardhësit e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) dhe ithtarët e tij (shiitët) e madhërojnë këtë ditë."

Ngjashëm, edhe The'alebi në librin "*Thimarul Kulub*", pasi përmend natën e Gadijrit ndër netët e veçanta dhe të njohura për umetin islam, thotë në faqen 511: "Ajo është nata kur Profeti (Paqja qoftë mbi të!) mbajti hutben e tij të nesërmen në Gadijr Kumm, mbi samarët e deveve, dhe tha në hutben e tij: "*Për atë që unë jam udhëheqësi i tij, edhe Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik me atë që është mik me të, dhe bëhu armik me atë që është armik i tij! Ndhimjoje atë që e ndihmon dhe poshtëroje atë që e poshtëron!*"

Shiitët e madhërojnë këtë natë dhe e gjallojnë atë me falje nate. Kjo vjen si pasojë e bindjes së tyre se në këtë ngjarje ka ndodhur emërimi i qartë dhe i drejtpërdrejtë i Aliut për udhëheqësi, pa ndërprerje. Edhe pse ata janë të veçuar nga të tjerët me këtë bindje, sërish ata ndajnë me

pjesën tjetër të umetit madhërimin e kësaj nate, e cila ka qenë gjithmonë një ndër netët e njohura të shënuara.

Kjo famë që i është dhënë kësaj nate nuk buron vetë nga bindja për madhësitë e saj dhe për një meritë të veçantë në mëngjesin e saj, kjo është ajo që e ka bërë atë një ditë të dëshmuar dhe një festë të bekuar.

Si pasojë e kësaj bindjeje për vlerën e ditës dhe natës së Gadijrit, ka ndodhur që ato të krahasohen në poezi për bukurinë dhe hijeshinë e tyre.

Poeti Temim ibn El Mu'izu, sundimtari i Egjiptit (i ndarë nga jeta më 374 hixhri), në një poezi të tij të përmendur nga El Bakherzij në librin "*Dumjetul Kasr*", f.38, thotë:

Na u afruan me sytë e tyre të bukur,

të hijshme, sikur ishin shkukur nga parfumi i lëkurës së tyre të buta,

nuk janë në gjendje të ngrihen,

kur ngrihen, nga rëndesa e ijeve të tyre.

Të bukura sikurse netët e Gadijrit,

erdhën me gjallëri si ditët e tyre të ndritshme.

Ndër gjërat që tregojnë për vlerën e kësaj dite është edhe: Urimi i bërë Prijësit të besimtarëve (Aliut) (Paqja qoftë mbi të!) nga dy khalifët, nënat e besimtarëve (gratë e Profetit) dhe nga të tjerë prej sahabëve, me urdhër të vetë të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), siç do të shohësh më vonë, me lejen e Allahut, në mënyrë të detajuar.

Ndërkohë, urimi është veçori e ditëve të festave dhe gëzimeve.

Çështja e dytë:

Kjo festë ka një rrënjë shumë të lashtë që shkon deri në kohën e Profetit. Fillimi i saj ishte pikërisht në ditën e Gadijr Kummit, gjatë Haxhit të Lamtumirës, kur Profeti i Islamit shpalli haptazi bazën e khalifatit të tij të madh dhe sqaroi për publikun fetar pozitën e lartë të udhëheqjes së tij, si në aspektin fetar ashtu edhe në atë shoqëror e politik. Ai ua qartësoi atyre nivelin dhe përmasën e lartë të fesë së tij.

Kjo ditë ishte një ngjarje madhështore, që gëzoi çdo musliman të sinqertë, sepse aty iu bë e qartë destinacioni i sheriatit dhe burimi i dritës së dispozitave të tij. Pas kësaj, ai (besimtari) nuk do të devijonte më nga epshet majtas e

djathtas dhe nuk do të rrëzohej në greminat e injorancës dhe pavlerësisë e të kotës.

A mund të ketë ditë më të madhe se kjo?

Në atë ditë u shfaqën më të dashurat prej syneteve, u qartësuan rrugët e udhëzimit, u përmbyll feja dhe u plotësua mirësia e Allahut, siç u shpall edhe në Kur'anin e Shenjtë.

Nëse është e pranueshme për njerëzit që ditën kur ndonjë mbret hipën në fronin e tij ta bëjnë festë, duke kremtuar me ndriçim, grumbullime publike, mbajtje fjalimesh, recitim poezish dhe shtruarje tryezash, siç është traditë tek shumë popuj dhe breza, atëherë dita kur u përmbyll mbretëria islame dhe autoriteti suprem fetar, për atë për të cilin erdhi shpallja e qartë nga Profeti i fesë së pastër, që nuk flet nga vetja, por është vetëm shpallje hyjnore, është më se e merituar të jetë ditë feste, dhe të festohet me nderim dhe respekt të plotë.

Meqë është nga festat fetare, duhet që në të të shtohen adhurimet që e afrojnë njeriun tek Allahu, si: agjërimi, falja e namazit, lutja dhe forma të tjera të bamirësisë, siç do ta shohësh më qartë në vendin përkatës, me lejen e Allahut.

Për të gjitha këto arsye, Profeti i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut mbi të dhe mbi familjen e tij!) urdhëroi që ata që ishin të pranishëm në këtë ngjarje nga umeti i tij,

përfshirë dy khalifët (shejkhët), pleqtë e Kurejshit dhe krerët e ensarëve, si dhe urdhëroi edhe gratë e tij (Nënat e besimtarëve), që të hynin te Imami Aliu (Paqja qoftë mbi të!) dhe ta uronin për këtë pozitë të lartë, për ngjitjen e tij në shkallën e udhëheqjes dhe autoritetit të urdhrit dhe ndalimit në fenë e Allahut.

Hadithi i urimit të imam Aliut pas caktimit

Imam Taberij, Muhamed ibn Xheriri, ka transmetuar në librin e tij “El Ulajetu” një hadith me zinxhir transmetimi nga Zejd ibn Erkam. Një pjesë e madhe e këtij hadithi gjendet në faqet 214–216. Në fund të hadithit thuhet: “O njerëz! Thoni: ‘Të kemi dhënë për këtë çështje një zotim nga vetja jonë, një marrëveshje me gjuhët tona dhe një premtim me duart tona, të cilën do t’ua përcjellim fëmijëve tanë dhe familjeve tona. Nuk kërkojmë tjetër në vend të saj. Ti je dëshmitar për ne, dhe Allahu mjafton si dëshmitar. Thoni atë që ju kam thënë dhe përshëndeteni Aliun me titullin “Udhëheqës i besimtarëve” (Emîrul Mu’minîn), dhe thoni: **“Falënderimi i goftë Allahut, i Cili na udhëzoi drejt kësaj; e ne nuk do të ishim udhëzuar sikur të mos na kishte udhëzuar Allahu...”**”¹⁹. Allahu e di çdo zë dhe çdo tradhti të shpirtit. Pra, kush e thyen (zotimin), ai e thyen në dëm të vetes së tij, ndërsa kush e përmbush zotimin ndaj Allahut, Ai do t’i japë shpërblim të madh. Thoni atë që e kënaq Allahun prej jush, e nëse bëheni mohues, dijeni se Allahu është i pasur dhe s’ka nevojë për ju.”

Zejd ibn Erkam thotë: ‘Në atë moment, njerëzit nxituan të thoshin: ‘Po, dëgjuam dhe iu bindëm urdhrat të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij me zemrat tona.’

¹⁹ Sure “El Araf”, ajeti 43.

Dhe të parët që i dhanë dorën për të uruar Profetin (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe imam Aliun ishin: Ebu Bekri, Umeri, Othmani, Talha, Zubejri, dhe më pas të gjithë emigrantët (muhaxhirët), ndihmuesit (ensarët) dhe të tjerët nga njerëzit. Kjo zgjati derisa Profeti i fali namazin e drekës dhe të ikindisë në një kohë të vetme, dhe vazhdoi derisa fali namazin e akshamit dhe të jaciesë gjithashtu në një kohë të vetme, ndërkohë që njerëzit vazhdonin të bënin bej'ah (betimin e besnikërisë) dhe të jepnin dorën në shenjë pajtimi për tri ditë rresht.

Këtë e ka transmetuar, gjithashtu, Ahmedi ibn Muhamed Et Taberij, i njohur si El Khalilij, në librin e tij "Menakibu Ali ibn Ebi Talib", që është shkruar në vitin 411 Hixhri në Kajro, nga rruga e mësuesit të tij Muhamed ibn Ebi Bekër ibn Abdurrahman, dhe aty thuhet: 'Njerëzit u ngutën për t'i dhënë *bej'atin* (besën) dhe thanë: 'Dëgjuam dhe iu bindëm asaj që na urdhëroi Allahu dhe i Dërguari i Tij, me zemrat tona, me shpirtrat tanë, me gjuhët tona dhe me tërë gjymtyrët tona.' Pastaj u drejtuan te i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe te Aliu me duart e tyre. I pari që ia dha dorën Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte Ebu Bekri, pastaj Umeri, Talha, Zubejri, e më pas edhe muhaxhirët (emigrantët) dhe të gjithë të tjerët sipas klasave dhe pozitive të tyre, deri sa u falën dreka dhe ikindia në të njëjtën kohë, dhe akshami dhe jacia në të njëjtën kohë, dhe ata vazhduan ta japin bej'ahun dhe dorën për tri ditë radhazi. Sa herë që

vinte një grup i ri për t'i dhënë dorën, Profeti thoshte *"Falënderimi i qoftë Allahut, i Cili na ka dalluar mbi të gjithë botët."* Dhe dhënia e dorës u bë një traditë dhe zakon, të cilin e përdorën më pas edhe ata që nuk kishin të drejtë për të.

Ndërsa në librin *"En Neshru uet Tajju"*, thuhet: 'Njerëzit nxituan të thonë: 'Po, po, dëgjuam dhe iu bindëm urdhrit të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij; besuam me zemrat tona!' Pastaj vrapuan drejt të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe Aliut për t'ua dhënë dorën, derisa u falën dreka dhe ikindia në një kohë, dhe pjesa tjetër e ditës vazhdoi kështu deri sa u falën edhe akshami dhe jacia në një kohë. Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) sa herë vinte një grup, thoshte: *"Falënderimi i qoftë Allahut, i Cili na ka dalluar mbi botët."*

Meulaiij, Ueliullah El Lek'hanauij, në librin e tij *"Mir'atul Mu'minin"*, në përmendjen e hadithit të Gadijrit, thotë sipas përkthimit të kuptimit: Më pas e takoi Omeri dhe i tha: 'Urime, o bir i Ebu Talibit! U zgjove dhe e mbylle ditën si...' etj. Dhe çdo sahab që e takonte, e uronte imam Aliun për këtë çështje.'

Historiani Ibn Khauend Shah, i cili ka vdekur në vitin 903 hixhri, në librin e tij *"Reudatu Es Safa"*, vëllimi 2 nga pjesa e parë, f. 173, pasi përmend hadithin e Gadijrit, thotë sipas përkthimit të kuptimit: Pastaj i Dërguari i Allahut u ul në një tendë të veçantë për të, dhe urdhëroi që imam Aliu të ulej në një tendë tjetër. Pastaj urdhëroi që të gjithë njerëzit të

shkonin për ta uruar Alinë në tendën e tij. Dhe kur njerëzit përfunduan urimin, i Dërguari i Allahut urdhëroi që Nënata e besimtarëve (gratë e Profetit) të shkonin dhe ta uronin edhe ato. Ndër ata që e uruan ishte edhe Omer ibn El Khattab, i cili tha: 'Urime për ty, o bir i Ebu Talibit! Je bërë udhëheqësi im dhe udhëheqësi i të gjithë besimtarëve dhe besimtareve!'"

Historiani Gjijathuddijn, i cili ka vdekur në vitin 942 hixhri, në librin e tij "*Habibu Es Sijer*", vëllimi 3 nga pjesa e parë, f. 144, përkthimi i përmbajtjes së të cilit thotë: Pastaj, sipas urdhrit të Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!), imam Aliu u ul në një tendë të veçantë për të, dhe njerëzit shkonin ta vizitonin dhe ta uronin. Ndër ta ishte edhe Omer ibn El Khattab, i cili tha: 'Urime, urime, o bir i Ebu Talibit! U bërë prijësi im dhe prijësi i çdo besimtari e besimtareje.' Pastaj Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) urdhëroi që edhe Nënata e besimtarëve të hynin tek imam Aliu dhe ta uronin."

Sa i përket hadithit të urimit të dy shejkhëve (Ebu Bekrit dhe Omerit), atë e kanë transmetuar shumë nga dijetarët e hadithit, tefsirit dhe historisë prej njerëzve të sunetit, në një numër të madh që nuk mund të nënvlerësohet. Disa prej tyre e kanë transmetuar si hadith mursel (me një hallkë të shkëputur, por të pranuar siç transmeton një mysliman tjetër), e disa të tjerë me zinxhirë transmetimi të saktë, me transmetues të besueshëm që

përfundojnë tek më shumë se një sahabi, siç janë: Ibn Abasi, Ebu Hurejra, Bera ibn Azib dhe Zejd ibn Erkam.

Nga dijetarët që e kanë transmetuar hadithin e urimit janë:

1 - El Hafidh Ebu Bekr Abdullahu ibn Muhammed ibn Ebi Shejbe, i cili ka vdekur në vitin 235 hixhri (i përmendur në biografi f. 89), e ka transmetuar me zinxhirin e tij në librin “El Musannaf” nga Bera ibn Azib, i cili ka thënë: “Ishim me të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në një udhëtim dhe u ndalëm në Gadijr Khumm. U thirr: ‘Namazi është i grumbulluar’, dhe iu pastrua vendi nën një pemë për të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ai fali drekën, pastaj e mori për dore Aliun dhe tha: “*A nuk e dini se unë jam më parësor te çdo besimtar se vetvetja e tij?*” Ata thanë: Po.

Atëherë ai mori për dore Aliun dhe tha: “*O Allah! Për atë që unë jam udhëheqës, edhe Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik i atij që është mik i tij dhe bëhu armik i atij që është armik i tij!*”

Pas kësaj, Omeri e takoi Aliun dhe i tha: ‘Urime o biri i Ebu Talibit! U gëdhive dhe u ngryse udhëhqësi i çdo besimtari dhe besimtareje!’

2 - Imam i hanbelijve, Ahmed ibn Hanbeli, i cili ka vdekur në vitin 241 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith në librin e tij *“Musned”*, vëllimi 4, faqja 281, nga transmetimi i Affanit, nga Hammad ibn Selemeh, nga Ali ibn Zejd, nga Adij ibn Thabit, nga Bera ibn Azib, i cili ka thënë: “Ishim me të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!)...”, e deri në fund të tekstit të përmendur në rrugën e transmetimit të Ibn Ebi Shejbes, me përjashtim se nuk është përmendur fjala e parë “O Allah (الله)”.

3 - El Hafidh Ebu Abbas Esh Shejbanij En Neseui, i cili ka vdekur në vitin 303 hixhri (i përmendur në biografi fq. 100), ka thënë: Na ka treguar Hudbe, na ka treguar Hammad ibn Selemeh, nga Zejd, dhe Ebu Harun, nga Adij ibn Thabit, nga Bera ibn Azib, i cili ka thënë: “Ishim me të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Haxhin e Lamtumurës. Kur arritëm në Gadijr Khumm, u pastrua vendi për të Dërguarin e Allahut nën dy pemë dhe u thirr në mesin e njerëzve: *‘Namazi me xhemat’*. I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e thirri Aliun dhe e mori për dore, e vendosi në të djathtën e tij dhe tha: *“A nuk jam unë më parësor te çdo njeri se vetvetja e tij?”* Ata thanë: Po.

Ai tha: *“Ky është udhëheqësi i atij që unë jam udhëheqës. O Allah, bëhu mik i atij që është mik i tij dhe bëhu armik i atij që është armik i tij!”*

Pastaj e takoi Omer ibn Khattabi dhe i tha: 'Urime për ty! U gëdhive dhe u ngryse udhëheqës i çdo besimtari dhe besimtareje!'

4 - El Hafidh Ebu Ja'la El Mausuli, i cili ka vdekur në vitin 307 h. (i përmendur në biografi f. 100), e ka transmetuar këtë hadith në "Musned"-in e tij, nga Hudbe, nga Hammad, e deri në fund të zinxhirit dhe tekstit të përmendur në rrugën e Shejbanit (domenthënë rrëfimi është i njëjtë me atë që u përmend në pikën e mëparshme nga Shejbanij).

5 - El Hafidh Ebu Xha'fer Muhamed ibn Xherir Et Taberi, i cili ka vdekur në vitin 310 hixhri, në Tefsirin e tij, vëllimi 3, faqja 428, pasi përmend hadithin e Gadijr Khummit, thotë: "Pastaj e takoi Omeri dhe i tha: Urime për ty, o biri i Ebu Talibit! U gëdhive dhe u ngryse udhëheqësi im dhe udhëheqësi i çdo besimtari dhe besimtareje."

Ky është edhe qëndrimi i Ibn Abbasit, Bera ibn Azibit dhe Muhamed ibn Aliut (Muhamedi El Bakir, sipas komentuesve).

6 - El Hafidhu Ahmed ibn Ukte El Kufij, i cili ka vdekur në vitin 333 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith në librin e tij *“Kitabul Uilaje”*, që është në fillim të librit, nga mësuesi i tij Ibrahim ibn El Uelid ibn Hammad, nga Jahja ibn Ja’la, nga Harb ibn Subaih, nga djali i motrës së Humejd Et Tauijl, nga Ibën Xhed’an, nga Said ibn el-Musejjeb, i cili ka thënë: “I thashë Sa’d ibn Ebi Uakasit: Unë dua të të pyes për diçka, por më vjen frikë (ngurroj) nga ti.

Ai tha: Pyet për çfarë të duash, sepse unë jam xhaxhai yt.

I thashë: Më trego për qëndrimin e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ndër ju në ditën e Gadijr Khummit.

Tha: Po, qëndroi ndër ne në mesditë dhe e mori për dore Ali ibn Ebi Talibin dhe tha: “Për atë që unë jam udhëheqës, edhe Aliu është udhëheqës i tij. O Allah, bëhu mik i atij që është mik i tij dhe bëhu armik i atij që është armik i tij!”

Tha: Atëherë Ebu Bekri dhe Omeri i thanë: “O biri i Ebu Talibit, u gëdhive dhe u ngryse udhëheqës i çdo besimtari dhe besimtareje!”

7 - El Hafidhu Ebu Abdullah El Merzebanij El Baghdadij, i cili ka vdekur në vitin 384 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith me zinxhirin e tij nga Ebu Said El Khudrij në librin e tij *“Serakat Esh Shi’ri”*.

8 -El Hafidhu Ali ibn Omer Ed Darekutni El Baghdadij, i cili ka vdekur në vitin 385 hixhri, e ka transmetuar me zinxhirin e tij hadithin e Gadijr Khummit, dhe në të përmendet: Pasi e dëgjuan këtë, Ebu Bekri dhe Omeri i thanë Aliut: 'O biri i Ebu Talibit, u bëre dhe vazhdove të jesh kujdestari i çdo besimtari dhe besimtareje!'

Këtë e ka përmendur Ibën Haxheri në librin e tij "Es Sauaiku El Muhrika", f. 26. Gjithashtu, është përmendur edhe nga El Khatijb El Bagdadij në një formë tjetër në faqen 232.

9 - El Hafidhu Ebu Abdullah ibn Batta El Hanbeli, i cili ka vdekur në vitin 387 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith me zinxhirin e tij në librin "*El Ibanetu*", nga Bera ibn Azib, me formulimin që ka sjellë El Hafidh Ebu Abbas Esh Shejbanij, por me përjashtimin e fjalës "emsejte" (u ngryse).

10 - El Kadij Ebu Bekr El Bakilani El Bagdadij, i cili ka vdekur në vitin 403 hixhri (i përmendur në biografi f. 107), e ka përfshirë këtë hadith në librin e tij "*Et Temhid fi Usuliddijn*", në faqen 171.

11 - El Hafidhu Ebu Said El Kherkushi En Nisaburij, i cili ka vdekur në vitin 407 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith në librin e tij *“Shereful Mustafa”*, me zinxhirin e tij nga Bera ibn Azib, me të njëjtin formulim si ai i Ahmed ibn Hanbelit, dhe me një zinxhir tjetër nga Ebu Said El Khudrij, me këtë formulim: *“Pastaj Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: “Urime, urime për mua! Vërtet Allahu më veçoi mua me profetësi dhe familjen time me udhëheqje (imameti).”*”

Pastaj Omer ibn El Khattabi, takoi prijësin e besimtarëve, dhe i tha: ‘Lum për ty, o Ebu Hasan! U bërë udhëheqësi im dhe udhëheqësi i çdo besimtari dhe besimtareje!’

12 - El Hafidhu Ahmed ibn Merdeuejh El Isbahani, i cili ka vdekur në vitin 416 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith në Tefsirin e tij, nga Ebu Said El Khudrij, dhe në të thuhet: *“Pas kësaj, Omer ibn El Khattabi e takoi Aliun (Paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: ‘Urime për ty, o biri i Ebu Talibit! U gëdhive dhe u ngryse udhëheqësi im dhe udhëheqësi i çdo besimtari dhe besimtareje!’”*

13 - Ebu Is’hak Eth Tha’lebij, i cili ka vdekur në vitin 427 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith në tefsirin e tij *“El Keshful Bejan”*, ku thotë: Na njoftoi Ebul Kasim Jakub ibn

Ahmed Es Serij, nga Ebu Bekr Muhamed ibn Abdullah ibn Muhamed, nga Ebu Muslim Ibrahim ibn Abdullah El Kexhij, nga Haxhaxh ibn Menhal, nga Hammad (ibn Seleme), nga Ali ibn Zejd, nga Udi ibn Thabit, nga Bera ibn Azib, i cili ka thënë: 'Kur zbritëm me të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahutqofshin mbi të!) gjatë Haxhit të Lamtumirës, ishim në Gadijr Khumm, atje u thirr: "Namaz me xhemat!". Dhe u pastrua vendi për Profetin nën dy pemë.

Pastaj ai e kapi për dore Aliun dhe tha: 'A nuk jam më parësor për besimtarët se vetvetja e tyre?'

Ata thanë: Po.

Atëherë tha: "Ky është udhëheqësi i atij që unë jam udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik i atij që është mik i tij dhe bëhu armik i atij që është armik i tij!"

Pastaj Omeri e takoi dhe i tha: 'Urime për ty, o biri i Ebu Talibit! U bëre udhëheqësi i çdo besimtari dhe besimtareje!'

14 - El Hafidhu Ibn Es Sem'an Err Rrazij, i cili ka vdekur në vitin 445 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith me zinxhirin e tij nga Bera ibn Azib, me të njëjtin tekst siç është transmetuar nga Ahmed ibn Hanbeli.

Këtë e kanë përmendur: Muhibbuddin Et Taberi në librin *“Er Rijadu En Nadra”*, vëll. 2, fq. 169, dhe Esh Shenkiti në librin *“Hajatu Ali ibn Ebi Talib”*, f. 28.

15 - El Hafidhu Ebu Bekr El Bejhekij, i cili ka vdekur në vitin 458 hixhri, e ka transmetuar hadithin si hadith merfu'(i atribuar Profetit (Paqja e bekimet e Allahutqofshin mbi të!)), që shkon deri te Bera ibn Azib, siç është përmendur në: *“El Fusulul Muhimmeh”* i Ibn Es Sabbag El Malikij El Mekki, f. 25, dhe në *“Durreru Es Simtein”* i Xhemaluddin Ez Zerendij El Hanefij, me një zinxhir që vjen gjithashtu nga Ebu Hurejra, dhe do të përmendet më vonë një rrugë tjetër nga El Khauarizmi përmes Bera ibn Azib dhe Ebu Hurejres.

16 - El Hafidhu Ebu Bekr El Khatijb El Baghdadij, i cili ka vdekur në vitin 463 hixhri, e ka transmetuar këtë hadith me dy zinxhirë të saktë (të saktësuar) nga Ebu Hurejre, në faqet 232-233.

17 - Juristi Ebul Hasan Ibnul Megazilij, i cili ka vdekur në vitin 483 hixhri, në librin e tij *“El Menakib”*, ka thënë: Na ka njoftuar Ebu Bekër Ahmed ibn Muhamed ibn Tauan, i cili ka thënë: Na ka njoftuar Ebul Hasan Ahmed ibn

Husejn ibn Es Semmak, i cili ka thënë: Më ka treguar Ebu Muhamed Xha'fer ibn Muhamed ibn Nasir El Khuldij, i cili ka thënë: Më ka treguar Ali ibn Said ibn Kutajbe er-Ramli, i cili ka thënë: Më ka treguar Dumra... (dhe vazhdon zinxhiri dhe teksti i transmetimit njësoj si ai që përmendet te El Khatijb El Bagdadij, në faqet 232–233).

Dhe ai ka thënë, gjithashtu,: Na ka njoftuar Ebul Hasan Ahmed ibn El Muzaffer El Atar, i cili ka thënë: Na ka njoftuar Ebu Muhamed Ibn Es Sakka dhe, gjithashtu, Ebul Hasan Ali ibn Abdullahi El Kassab El Bajja' El Uasitij, nga ajo që më lejuan të transmetoj prej tyre, se: Më ka treguar Ebu Bekr Muhamed ibn El Hasan ibn Muhamed El Bejaserij, i cili ka thënë: Më ka treguar Ebul Hasan Ali ibn Muhamed ibn El Hasan El Xheuherij, i cili ka thënë: Më ka treguar Muhamed ibn Zekerija El 'Abdij, i cili ka thënë: Më ka treguar Humejd Et Taujil, nga Enesi, në një hadith ku thuhet: "Pastaj Profeti (Paqja e bekimet e Allahutqofshin mbi të!) e kapi për dore (Aliun) dhe e ngjiti në minber, dhe tha: "O Allah! Ky është prej meje dhe unë jam prej tij. Ai ka tek unë pozitën që Haruni kishte tek Musait. Vërtetm, për këdo që unë jam udhëheqës i tij, ky (Aliu) është udhëheqësi i tij!"

Pastaj Aliu u largua me zemër të qetë dhe të gëzuar. Omer ibn El Khattabi e ndoqi dhe i tha: 'Urime, urime, o Ebu Hasan! U bëre udhëheqësi im dhe udhëheqësi i çdo muslimani!'

18 – Ebu Muhamed Ahmed El ‘Asimi, ka thënë në veprën e tij *“Zejnul Feta”*: Më ka njoftuar Shejkhun im Muhamed ibn Ahmed (Allahu e mëshiroftë!) i cili ka thënë: Na njoftoi Ebu Ahmed El Heluanij, i cili ka thënë: Na tregoi Ebu Xha’fer Muhamed ibn Ibrahim ibn Muhamed ibn Abdullah ibn Xhebla El Kuhistani, i cili ka thënë: Na tregoi Ebu Kurejsh Muhamed ibn Xhum’a ibn Khalf El Kainij, i cili ka thënë: Na tregoi Ebu Jahja Muhamed ibn Abdullah ibn Jezid El Mukrij, i cili ka thënë: Na tregoi babai im, i cili ka thënë: Na tregoi Hammad ibn Seleme, nga Ali ibn Zejd ibn Xhuda’an, nga Udej ibn Thabit, nga Bera ibn Azib, i cili ka thënë: *“Kur i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahutqofshin mbi të!) tha: “Për atë unë jam udhëheqës, ky (Aliu) është udhëheqësi i tij,” atëherë Omer tha: ‘Urime për ty, o Ebu Hasan! U bëre udhëheqësi i çdo muslimani!’”*

Dhe, gjithashtu, ai tha: Na njoftoi Muhamed ibn Ebi Zekerijja, Allahu e mëshiroftë, i cili tha: Na njoftoi Ebul Hasan Muhamed ibn Omer ibn Behteh El Bezzaz, duke lexuar Ebul Fet’h ibn Ebil Feuaris El Hafidh në Bagdad, dhe ai e pranoi. Ai tha: Na njoftoi Ebul Abbas Ahmed ibn Muhamed ibn Said ibn Abdurrahman ibn Ukte El Heluanij, meula i Benu Hashimit, duke lexuar nga origjinali i librit të tij në vitin 330 H kur kishte ardhur në Bagdad. Ai tha: Na tregoi Ibrahim ibn Velid ibn Hammad, i cili tha: Na njoftoi babai im, i cili tha: Na tregoi Jehja ibn Ja’la... (dhe vazhdon me të njëjtin zinxhir dhe tekst të përmendur më sipër, faqe 273, nëpërmjet hafizit Ibn Ukte në zinxhirin dhe tekstin e tij).

19 - El Hafidhu Ebu Sa'd Es Sem'ani (ka vdekur në vitin 562 hixhri), në librin e tij *"Fadailu Es Sahabe"*, e ka transmetuar këtë hadith me zinxhirin e tij nga Bera ibn Azib, me të njëjtin tekst si ai që përmendet nga Ahmed ibn Hanbeli, faqja 272.

20 - Huxhetul Islam Ebu Hamid El Gazalij (ka vdekur në vitin 505 hixhri), në veprën e tij *"Sirrul 'Alemin"*, f. 9, ka thënë: "Të gjithë masat e dijetarëve janë pajtuar për tekstin e këtij hadithi nga hutbeja e Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në ditën e Gadijr Khummit, sipas konsensusit të të gjithëve, ku ai tha: *"Për atë që unë jam udhëheqës, ky (Aliu) është udhëheqësi i tij."*

Pastaj Omeri tha: 'Urime, urime për ty, o Ebu Hasan! Vërtet u bërë udhëheqësi im dhe udhëheqësi i çdo besimtari dhe besimtareje!'

21 - Ebul Feth El Esh'ari Esh Shehristanij (ka vdekur në vitin 548 hixhri), ka thënë në librin *"El Milel ue En Nihal"*, i shtypur në fund të librit *"El Fasl"* të Ibn Hazmit, vëll. 1, f. 220: "Ngjashëm me atë që ndodhi në plotësimin e Islamit dhe përmirësimin e gjendjes kur zbriti fjala e Allahut të Lartësuar: **"O i Dërguar! Shpall atë që të është zbritur**

nga Zoti yt. E nëse nuk e bën, atëherë nuk e ke përçarur shpalljen e Tij.”

Kur arriti në Gadijr Khumm, urdhëroi për ngritjen e platformave, dhe ato u ngritën, pastaj thirrën: *“Namazi me xhemat”*, dhe më pas ai (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha mbi devën e tij: *“Për atë që unë jam udhëheqës (meula), ky (Aliu) është udhëheqësi i tij. O Allah, dua je atë që e do atë, dhe armiqësoje atë që e armiqëson atë! Ndihamoje atë që e ndihmon dhe poshtëroje atë që e lë vetëm! Bëje të vërtetën të jetë me të, kudo që ai të jetë! A e kam përçarur?”* – dhe e përsëriti këtë tri herë.

Imamijtë (shiitët) pretendojnë se ky është një tekst i qartë (nas sarih). Ne shikojmë kush ishte udhëheqës për profetin dhe çfarë kuptimi ka fjala “meula” që të vlejë edhe për Aliun.

Sahabët kuptuan nga ky emërim të njëjtën gjë që kuptuam edhe ne, aq sa Omeri, kur e takoi Aliun, i tha: *“Urime për ty, o Ali! U bërë udhëheqësi i çdo besimtari dhe besimtare!”*

22 -Khatibi më i njohur (El Khâtibul Khuteabâ) El Khëarizmi El Hanefi (ka vdekur në vitin 568 hixhri), në librin e tij *“Menakibul Khauarizmi”*, f. 94, transmeton nga: Ebul Hasan Ali ibn Ahmed El ‘Asimi El Khëarizmi, nga Ismail ibn Ahmed El Ua’idh, nga El Hafidh Ebu Bekr El

Bejheki, nga Ali ibn Ahmed ibn Hamdan, nga Ahmed ibn Ubejd, nga Ahmed ibn Sulejman El Mue'dib, nga Othman ibn Ebi Shejbe, nga Zeid ibn Hubab, nga Hammad ibn Seleme, nga Ali ibn Zejd ibn Xhuda'an, nga Udej ibn Thabit, nga Bera ibn Azib, i cili ka thënë: 'Erdhëm bashkë me të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në haxhin e tij, dhe kur ishim mes Mekës dhe Medinës, Profeti zbriti dhe urdhëroi që të thirrej: *"Namazi me xhemat."*

Më pas mori për dore Aliun dhe tha: *"A nuk jam unë më parësor për besimtarët sesa vetvetet e tyre?"* Ata thanë: *"Po."*

Ai (Profeti) tha: *"Ky është udhëheqësi i atij që unë jam udhëheqës i tij. O Allah, duaje atë që e do atë dhe armiqësoje atë që e armiqëson atë! Për atë që unë jam udhëheqës (meula), ky (Aliu) është udhëheqësi i tij."*

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e tha këtë me zë të lartë, e më pas Omeri e takoi Aliun dhe i tha: *"Urime për ty, o biri i Ebu Talibit! U bëre kujdestari im dhe i çdo besimtari dhe besimtareje!"*

Dhe me të njëjtin zinxhir të transmetimit nga hafizi Ebu Bekr El Bejheki, nga El Hafidh Ebu Abdullah El Hakim, nga Ebu Ja'la Ez Zubejri ibn Abdullah Eth Theuri, nga Ebu Xha'fer Ahmed ibn Abdullah El Bezzar, nga Ali ibn Said, nga Dumre, nga Ibn She'dheb...vazhdon hadithi i njëjtë që përmendet edhe nga El Khatib El Baghdadi në faqet 232-233, me të njëjtin zinxhir dhe tekst.

23 - Ebul Ferexh Ibnul Xheuzy El Hanbeli (ka vdekur në vitin 597 hixhri). E ka transmetuar në librin e tij *“Menakib”* nga rruga e Imam Ahmed ibn Hanbelit, me zinxhirin e transmetimit nga Bera ibn Azib, me të njëjtin tekst të përmendur më parë.

24 - Fakhruddin Err Rrazi Esh Shafi’ij (ka vdekur në vitin 606 hixhri). E ka transmetuar në Tefsirin e tij të Madh (*Et Tefsirul Kebijr*), vëll. 3, f. 636, dhe në botimin tjetër f. 443, me të njëjtin tekst të përmendur më herët (faqe 219).

25 - Ebu Sa’adat Mexhduddin Ibnul Esir Sh Shejbanij (ka vdekur në vitin 606 hixhri). Ka thënë në librin *“En Nihaje”*, vëll. 4, f. 246, pas përmendjes së kuptimeve të fjalës *“meula”*: *“Ndër to është edhe hadithi: “Për atë që unë jam udhëheqës (meula), ky (Aliu) është udhëheqësi i tij.” Dhe fjalët e Omerit drejtuar Aliut: “U bëre udhëheqësi i çdo besimtari.””*

26 - Ebul Fet’h Muhamed ibn Ali En Natnazi, e ka transmetuar në librin e tij *“El Khasa’is El Aleuijje”*, me zinxhirin e vet, hadithin nga Ebu Hurejre, me të njëjtin tekst

të përmendur më herët, përmes rrugës së Hatibit El Bagdadij, faqe 232.

27 - Izzuddin Ebul Hasan Ibnul Esir Esh Shejbanij (ka vdekur në vitin 630 hixhri), ka transmetuar me zinxhirin e tij nga Bera ibn Azib, me të njëjtin tekst që kaloi më parë në faqen 178.

28 - El Hafidh Ebu Abdullah El Kenxhij Esh Shafi'ij (ka vdekur në vitin 658 hixhri), ka thënë në librin *"Kifajetu Et Talib"*, f. 16: "Na tregoi El Hafidh Jusuf ibn Khalil Ed Dimeshkij në Haleb (Alepo), na tregoi Esh Sherijf Ebul Muammer Muhamed ibn Hajdare El Husejnij El Kufij në Bagdad, dhe, gjithashtu, na tregoi Ebul Gana'im Muhamed ibn Ali ibn Mejmun En Nersi në Kufe, dhe Ebul Muthenna Darim ibn Muhamed ibn Zejd En Nehshelij, i cili ka thënë: Na tregoi Ebul Hakim Muhamed ibn Ibrahim ibn Es Serij Et Temimij, nga Ebul Abbas Ahmed ibn Muhamed ibn Said El Hilalij (i njohur si Ibn Ukdetu), nga Ibrahim ibn El Uelid ibn Hamad, nga babai i tij, nga Jahja ibn Ja'la, nga Harb ibn Sabih, nga nipi i Humejd Et Tauijl..." Deri në fund të transmetimit që kaloi më herët në faqen 273 nga Ibn Ukdetu, me zinxhir dhe tekst.

29 - Shemsuddin Ebul Mudhaffar Sibt Ibnul Xheuzi El Hanefi (ka vdekur në vitin 654 hixhri), ka përmendur në *“Tedhkiratu Es Sibt”*, f. 18, nga veprat që tregojnë virtytet që transmetohen nga Ahmed ibn Hanbeli, me zinxhir dhe tekstin e përmendur në faqen 272.

30 - Omer ibn Muhamed El Mul’la, e ka transmetuar në librin e tij *“Uesiletul Mute’abbidijn”*, nga Bera ibn Azib, me të njëjtin version që transmeton Imam Ahmedi.

31 - El Hafidh Ebu Xhafer Muhibbuddin Et Taberij Esh Shafi’ij (ka vdekur në vitin 694 hixhri), ka transmetuar në librin *“Err Rrijad En Nadra”*, vëll. 2, f. 169, nëpërmjet imam Ahmed ibn Hanbelit, nga Bera ibn Azib dhe Zejd ibn Erkam, me të njëjtin tekst të përmendur më parë. Po ashtu, e transmeton në librin *“Dhekha’irul ‘Ukba”*, f. 67, përmes rrugës së imam Ahmedit, me versionin e Bera ibn Azibit.

32. Shejkhul Islam El Hameunij (ka vdekur në vitin 722 hixhri). Ka thënë në librin *“Feraid Es Simtejn”*, kapitulli i trembëdhjetë: “Na tregoi shejhu, imami Imaduddin Abdul Hafidh ibn Bedran, me lexim timin në qytetin Nablus në xhaminë e tij. I thashë: A të ka treguar gjykatësi Ebul Kasim Abdu’s Samed ibn Muhamed ibn Ebil Fadl El Ensarij El

Haristani me leje? Ai e pranoi dhe tha: Më ka treguar Ebu Abdillah Muhamed ibn Ebil Fadl El 'Arauij me leje, i cili tha: Më ka treguar Shejhu i Sunnetit Ebu Bekr Ahmed ibn El Husejn El Bejhekij, i cili tha: Më ka treguar Hakim Ebu Ja'la Ez Zubejr ibn Abdillah En Nurij, i cili tha: Më ka treguar Ebu Xhafer Ahmed ibn Abdillah El Bezzaz, nga Ali ibn Seid El Berkij, nga Dhamra ibn Rebia, nga Ibn Shudheb, nga Matar El Uarrak, nga Shehr ibn Hushab, nga Ebu Hurejre..."

Me të njëjtin tekst të përmendur më herët nga Hatib El Bagdadij (faqe 232).

Gjithashtu ai thotë: "Na tregoi imami zahid, Vahiduddin Muhamed ibn Ebi Bekr ibn Ebi Jezid El Xhuvetni, me lexim timin në Khairabad, në muajin Xhumada El Ula të vitit 663 H, i cili tha: Na tregoi imami Seraxhuddin Muhamed ibn Ebil Futuh El Jakubij me dëgjim, i cili tha: Na tregoi babai i tij, imami Fakhruddin Ebul Futuh ibn Ebi Abdillah Muhamed ibn Omer ibn Jakub, i cili tha: Na tregoi shejhu, imami Muhamed ibn Ali ibn El Fadl El Kariju." Dhe vijon: 'Më tregoi imami fisnik, Fakhruddin El Murtada ibn Mahmud El Husejni El Ishtari, me leje për transmetim në vitin 671 H, nga babai i tij. Ai tha: Më ka treguar imami Mexhduddin Ebul Kasim Abdallah ibn Muhamed El Kezuenij, i cili tha: Na tregoi Xhemalus Sunne Ebu Abdillah Muhamed ibn Hamuvije ibn Muhamed El Xhuvetni, i cili tha: Na tregoi Xhemalul Islam Ebul Mehasin Ali ibn Shejkhul Islam El Fadl ibn Muhamed El Farandij, i cili tha: Na tregoi imami Abdallah ibn Ali,

udhëheqës i kohës së tij në tarikatin sufi dhe ndër më të dalluarit në shariat. Ai tha: Na tregoi Ebul Hasan Ali ibn Muhamed ibn Bendari El Kezuenij në Mekë. Na tregoi Ali ibn Omer ibn Muhamed El Hebrî me lexim, nga Muhamed ibn Ubejde El Kadi, nga Ibrahim ibn El Haxhaxh, nga Hammad, nga Ali ibn Zejd dhe Ebu Harun El Abdij, nga Udej ibn Thabit, nga Bera ibn Azib, i cili ka thënë: 'Erdhëm me Profetin (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Haxhin e Lamtumirës. Kur arritëm në Gadijr Khumm, ai na thirri: *"Namazi me xhemat"* dhe pastroi një vend nën dy pemë për Profetin (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Pastaj Profeti mori për dore Aliun dhe tha: *"A nuk jam më parësor te besimtarët se vetvetet e tyre?"*

Ata thanë: *"Po!"*

Pastaj tha: *"A nuk kam më shumë të drejtë ndaj çdo besimtari se vetvetja e tij?"*

Thanë: *"Po!"*

Tha: *"A nuk janë gratë e mia nënat e tyre?"*

Thanë: *"Po!"*

Pastaj tha: *"Atëherë ky është udhëheqësi (meula) i atij që unë jam udhëheqësi i tij. O Allah! Dua je atë që e do dhe armiqësoje atë që e armiqëson!"*

Më pas Omeri e takoi dhe i tha: “Urime për ty, o bir i Ebu Talibit! U bërë udhëheqës i çdo besimtari dhe besimtareje.”

Pastaj El Hameuinij vazhdon: ‘Këtë e ka përmendur imami, hafizi, shejhu i Sunnetit, Ebu Bekr Ahmed ibn El Husejn El Bejheki, në librin e tij për virtytet e komandantit të besimtarëve Aliut (r.a.). E kam kopjuar nga dora e tij e bekuar.’

33 - Nidhâmuddin El Kummi En Nejsaburij.

Transmetimi i tij u përmend më lart ku përcjell fjalët e Ebu Said El Khudri.

34 - Uelijuddin El Khatijb, e ka transmetuar në librin “*Mishkatul Mesabijh*” (autorësia rreth vitit 737 hixhri) faqja 557, përmes transmetimit të Ahmedit nga Bera bin Azib dhe Zejd bin Erkam me të njëjtat fjalë si në faqen 272.

35 - Xhemaluddin Ez Zerendi El Medenij, i cili ka vdekur rreth mesit të shekullit të tetë hixhri, e ka transmetuar në librin e tij “*Durrer Es Simtein*” përmes rrugës së Hafiz Ebu Bekr El Bejhekiut, me zinxhirin e transmetimit nga Bera bin Azib, me të njëjtat fjalë që i përmend edhe El Hameuijni. Në të thuhet: ‘Derisa arritëm në Gadijr Khumm

ditën e enjte, më 18 Dhul Hixhe, u bë thirrje ndër ne për namazin me xhemat'

36 - Ebu El Fida Ibn Kethîr Esh Shami Esh Shafi'îj (ka vdekur në vitin 774 hixhri), e ka transmetuar në librin e tij "*El Bidajeh ue En Nihajeh*, vëllimi 5, faqet 209-210, me fjalët e Ahmed ibn Hanbelit nga Bera bin Azib, përmes dy hafizëve Ebu Ja'la El Mausilî dhe Hasan ibn Sufjan. Gjithashtu, nga Bera përmes rrugës së Ibn Xheririt nga Ebu Zure'a nga Musa ibn Ismail "El Munkerî" nga Hammad ibn Seleme nga 'Ali ibn Zejd dhe Ebu Harun El 'Abdî nga 'Udej ibn Thâbit nga Berae. Po ashtu, nga Musa ibn Uthman El Khadrami nga Ebu Ishâk Es Sebei nga Bera dhe Zejd ibn Erkam. Në faqen 212, ai gjithashtu transmeton nga Ebu Hurejre me fjalët e Khatijb El Bagdadit.

37 - Takijuddin El Makrizi El Misrî (ka vdekur në vitin 845 hixhri), e përmend në "*El Khuttat*", vëllimi 2, faqja 223, përmes transmetimit të Ahmedit nga Bera bin Azib me të njëjtat fjalë.

38 - Nuruddijn Ibn Es Sabbagh El Malikij El Mekki (ka vdekur në vitin 855 hixhri), e ka cituar në librin

“El Fusul El Muhimeh:”, faqja 25, nga Ahmed dhe Hafiz El Bejhekij, nga Bera bin Azib me të njëjtat fjalë si të tyre.

39 – El Kadij Nexhmuddijn El Ezra’i Esh Shafi’ij (ka vdekur në vitin 876 hixhri), thotë në *“Bediul Me’ani”*, faqja 75: Është përcjellë se Omer ibn El Khattab (Allahu qoftë i kënaqur me të!) kur dëgjoji fjalët e Profetit ﷺ: “Për atë që jam unë udheheqës (meëla), Aliu është udhëheqës i tij”, i tha Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të!): “Urime për ty! Tashmë je bërë udhëheqësi i çdo besimtari dhe besimtareje.”

40 – Kemaluddijn El Mejbidhi në *“Sherhu Ed Diuan”* e atribuar Emirul Mu’mininit (imamit Ali), faqja 406, ka përmendur hadithin e transmetuar nga Ahmed përmes Bera bin Azib dhe Zejd bin Erkam me të njëjtat fjalë të përmendura.

41 – Xhelaluddijn E Sujuti (ka vdekur në vitin 911 hixhri), e ka transmetuar në *“Xhem’ul Xheuami’u”*, siç citohet në *“Kenzul ‘Ummali”*, vëllimi 6, faqja 397, duke e marrë nga Hafiz Ibn Ebi Shejbe me të njëjtat fjalë si në faqen 272.

42 - Nuruddijn Es Semhudij El Medenij Esh Shafi'ij (ka vdekur në vitin 911 hixhri), e ka transmetuar në librin e tij *“Uefa’ul Uefâ bi Akhbari Daril Mustafa”*, vëllimi 2, faqja 173, duke e përcjellë nga Ahmed përmes rrugës së tij nga Bera dhe Zejd.

43 - Ebu El ‘Abbas Shehabuddijn El Kastallanj (ka vdekur në vitin 923 hixhri), ka thënë në librin *“El Meuahib El Ledunijeh”*, vëllimi 2, faqja 13, në shpjegim të kuptimit të fjalës *“meulâ”* (kujdestar): “Dhe fjala e Omerit: ‘U bëre udhëheqës i çdo besimtari’, do të thotë: ‘je bërë mbrojtësi dhe udhëheqës i çdo besimtari’.”

44 - Sejid ‘Abdul Uehab El Husejnî El Bukhârî (ka vdekur në vitin 932 hixhri), është përmendur teksti i tij në faqen 221.

45 - Ibn Haxher El ‘Askalanij El Hejthemij (ka vdekur në vitin 973 hixhri), ka thënë në librin *“Es Saua’iku El Muhrika”*, faqja 26, në lidhje me kuptimin e hadithit: ‘Le të pranojmë që ai (mami Aliu) është më i afërt, por nuk pranojmë që kuptimi është më i afërt me udhëheqjen (imamatin), por me ndjekjen dhe afërsinë shpirtërore me të’. [Më tej ai thotë]: ‘Dhe këtë e kanë kuptuar Ebu Bekri dhe

Omeri dhe mjafton që ata e kanë kuptuar kështu, sepse kur e dëgjuan këtë, i thanë Aliut: 'O biri i Ebu Talibit, u ngryse në udhëheqës i çdo besimtari e besimtareje.' E ka transmetuar Ed Darakutni.

46 - Sejid Ali ibn Shihabuddijn El Hamedani e ka transmetuar këtë në librin "*Meueddetul Kurba*" sipas formulimit të transmetuar nga Bera ibn Azib.

47 - Sejid Mahmud Shejhani El Kaderi El Medinij ka thënë në librin e tij "*Es Sirat Ss Seuif fi Menakibi ale En Nebij*": E kanë transmetuar Ebu Ja'la dhe Hasan ibn Sufjan në musnedët e tyre nga Bera ibn Azib, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ka thënë: 'Ishim me të Dërguarin e Allahut në Haxhin e Lamtumirës...' dhe vazhdon deri në fund të transmetimit të përmendur nga ata të dy. Pastaj ai shton: Hafizi Dhehebi ka thënë: "Ky është një hadith *hasen* (i mirë) dhe shumica e dijetarëve të Ehli Sunnetit janë pajtuar për këtë që përmendëm."

Pastaj ai thotë në sqarimin e asaj që është e saktë nga hutbeja e Gadijr Khummit: Dhe e saktë nga ato që përmendëm është gjithashtu thënia e Profetit (Paqja qoftë mbi të!): "*A nuk jam unë më parësor për çdo besimtar se vetja e tij?*" Ata thanë: Po.

Ai tha: *“Për këdo që unë jam udhëheqës i tij, ky (Aliu) është udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik me atë që është mik i tij, dhe bëhu armik me atë që është armik i tij!”*

Pastaj e takoi Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe i tha: *“Urime për ty, tani je gëdhrë dhe je ngrysur udhëheqës i çdo besimtari dhe besimtare.”* Kjo është fundi i asaj që është e saktë dhe e bukur, dhe në të nuk ka shpikje apo trillime nga ndonjë pretendues... etj. Do të vijojë pjesa tjetër e fjalëve të tij lidhur me zinxhirin (senedin) e transmetimit të hadithit.

48 - Shemsuddikn El Menauij Esh Shafi’ij, i cili ka vdekur në vitin 1031 hixhri, ka thënë në librin *“Fajdhul Kadir”*, vëll. 6, f. 218: Kur Ebu Bekri dhe Omeri e dëgjuan këtë (hadithin e Uilajetit), thane, sipas asaj që ka transmetuar Darekutni nga Sa’d ibn Ebi Uekas: *“O biri i Ebi Talibit, tani je bërë udhëheqës i çdo besimtari dhe besimtare.”*

49 - Shejkh Ahmed Bakthijr El Mekkiy Esh Shafi’ij, i cili ka vdekur në vitin 1047 hixhri, e ka transmetuar në librin *“Uesiletul Meal fi 'Addi Menakibil ali”*, me formulimin e Bera ibn Azibit.

50 - Ebu Abdallah ez-Zerkani el-Maliki, i vdekur në vitin 1122 hixhri, ka thënë në librin *"Sherhul Meuahib"*; vëll. 7, f. 13: Darekutni ka transmetuar nga Sa'di i cili ka thënë: "Kur Ebu Bekri dhe Omeri e dëgjuan këtë, thanë: 'O biri i Ebu Talibit, tani je bërë udhëheqës i çdo besimtari dhe besimtare.'"

51 - Husamuddin ibn Muhamed Bajezid Es Seharanpuri e ka përmendur këtë në librin *"Merafidh Er Reuafidh"*, me të njëjtin formulim, në faqen 143.

52 - Mirza Muhamed El Badakhshani e ka përmendur këtë në dy librat e tij: *"Miftah En Nexha fi Menakib Ali'l Abba"* dhe *"Nuzul El Ebrar bima Sahhe fi Ehli'l Bejt El Et'har"*, nga Berae dhe Zejdi, nëpërmjet rrugës së transmetimit të imam Ahmedit.

53 - Shejkh Muhamed Sadrul Alem e ka përmendur hadithin e urimit në librin *"Me'arixh El Ula fi Menakib El Murtada"*, nga rruga e transmetimit të imam Ahmedit përmes Berae ibn Azibi dhe Zejdit.

54 - Ebu Uelijullah Ahmed El Umri Ed Dehlauj, i cili ka vdekur në vitin 1176 hixhri, e ka përmendur me të njëjtin shprehje në faqen 144.

55 - Sejid Muhamed Es San'anij, i cili ka vdekur në vitin 1182 hixhri, e ka përmendur këtë në librin *“Err Rraudah En Nedijje fi Sharh Et Tuhfet El Alije”* nga Muhibbuddijn Et Tabarij, i cili e transmeton nga rruga e imam Ahmedit përmes Berae ibn Azib.

56 - Mulla Muhamed Mubijn El Lekhnauj e ka përmendur këtë në librin *“Uesiletu Nexhati”*, nga transmetimi i Bera’e ibn Azib dhe Zejd ibn Erkam.

57. Mulla Uelijullah El Lekhnauj e ka përmendur në librin *“Mir’atul Mu’minin fi Menakib Ehli Bejt Sejdidil Murselin”*, me shprehjen e imam Ahmedit, dhe pastaj ka thënë: Në një transmetim tjetër thuhet: “Bekim për ty, o Ali! Tani je gëdhirë e je ngrysur...” – etj.

58 - Muhamed Mahbub El Alem e ka përmendur këtë në *“Tefsir Shahi”*, nga Ebu Seid El Khudri, siç është

përmendur më herët në faqen 221, me formulimin e transmetuar nga En Nejsaburi.

59. Sejid Ahmed Zejni Dahlani El Mekki Esh Shafi'ij, i cili ka vdekur në vitin 1304 hixhri, ka thënë në librin *“El Fetuhat El Islamiije”* (vëll. 2, f. 306): ‘Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e donte shumë Aliun dhe Ehli Bejtin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ka ardhur shumë prej tij në këtë drejtim. Nga ato është edhe kjo: Kur Profeti ﷺ tha: ‘Për atë që unë jam udhëheqës (ëali), Aliu është udhëheqësi i tij.’ Ebu Bekri dhe Omeri thanë: ‘O biri i Ebu Talibit, u ngryse (u bëre) udhëheqës i çdo besimtari dhe besimtare.’”

60. Shejkh Muhamed Habijbullah Esh Shenkitij El Medinij El Malikij e ka përmendur këtë në librin *“Kifajetu Et Talib fi hajati Ali ibn Ebi Talib”*, f 28, nga rruga e ibn Es Semmani përmes Berae ibn Azib, dhe nga rruga e imam Ahmedit përmes Zejd ibn Erkam, me të njëjtin shprehje të përmendur.

Hadithi i Gadijrit në burimet e Ehli Sunetit

1- Profeti Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha në ditën e Gadijr Khummit: *“A nuk jam unë më i afërt dhe më me të drejtë ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetvetes së tyre? Dhe a nuk janë gratë e mia nënat e tyre?”*

Ne thamë: “Po, o i Dërguari i Allahut!”

Ai tha: *“Atëherë, kujtdo që unë jam udhëheqës i tij, Aliu është udhëheqës i tij. O Allah, duaje atë që e do atë dhe bëhu armik i atij që është armik i tij!”*²⁰ (<https://forums.alkafeel.net/>)

2- Zadhan Ebu Umer transmeton: ‘Kam dëgjuar Aliun në Rahbetu, duke u drejtuar njerëzve dhe duke thënë: “Kërkoj nga ata që kanë qenë të pranishëm me të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në ditën e Gadijr Khummit dhe e kanë dëgjuar atë që tha, të dëshmojnë.’

Atëherë u ngritën trembëdhjetë burra dhe dëshmuan se e kishin dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij) duke thënë: *“Kujtdo*

²⁰ Transmetuar në “Musned Ahmed”, hadithi nr. 915.

që unë jam udhëheqës i tij, Aliu është udhëheqësi i tij.”²¹ (<https://forums.alkafeel.net/>)

3- Transmetohet se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij) ka thënë në ditën e Gadijr Khummit: *“Kujtdo që unë jam udhëheqës i tij, Aliu është udhëheqësi i tij.”* Transmetuesi (ndoshta Ebu Merjemi ose dikush tjetër) thotë se njerëzit më vonë shtuan: *“O Allah, dua je atë që e do atë dhe bëhu armik i atij që është armik i tij.”²² (<https://forums.alkafeel.net/>)*

Megjithatë, kjo shtesë nuk është nga fjalët e njerëzve, por është transmetuar gjithashtu nga vetë Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij) nëpërmjet transmetimit të Zajd ibn Erkam, në hadithin nr. 18522 të Musnedi të Ahmedit.

Për më tepër, kjo shtesë gjendet edhe në burime të tjera hadithore, si të Ehli Suneti ashtu edhe të Shiitët, prandaj nuk ka dyshim se ajo është thënë nga Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij).

4- Nga Ebu Serha ose nga Zayd ibn Ali transmetohet se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe

²¹ Transmetuar në “Musned Ahmed”, hadithi nr. 906.

²² “Musned Ahmed”, hadithi nr. 1242.

familjen e tij) ka thënë: “Kujtdo që unë jam udhëheqës i tij, Aliu është udhëheqësi i tij.”²³ (<https://forums.alkafeel.net/>)

5- Sa’d ibn Ebi Uekasi i tha Muavije ibn Ebi Sufjanit, pasi ky i fundit foli keq për Aliun (Paqja qoftë mbi të!): ‘Ti po e thua këtë për një burrë për të cilin e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) të thotë: “Kujt i kam qenë unë udhëheqës, Aliu është udhëheqësi i tij.”’²⁴ (<https://forums.alkafeel.net/>)

6- Transmetohet nga Amir ibn Sa’d, nga Sa’di, se i Dërguari i Allahut mbajti një hutbe dhe tha: “E pra, o njerëz, unë jam udhëheqësi juaj.”

Ata thanë: ‘Ke thënë të vërtetën.’

Pastaj ai mori dorën e Aliut, e ngriti dhe tha: “Ky është velijju im dhe ai që përcjell prej meje. O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe bëhu armik i atij që e armiqëson atë.”²⁵ (<https://forums.alkafeel.net/>)

7- Transmetohet nga Aishe bintu Sa’d, nga Sa’di, se ka thënë: I Dërguari i Allahut mori dorën e Aliut, mbajti një hutbe, e falënderoi Allahun dhe e lavdëroi Atë, pastaj tha:

²³ “Musned Et Tirmidhij”, Kitabul Menakib, hadithi nr. 3646.

²⁴ “Sunen Ibn Maxhah”, numri i hadithit 118.

²⁵ “Khasa’isul imam Emiril Mu’minijn Ali ibn Ebi Talib”, f. 176, hadithet nr. 94 dhe 95.

"A nuk e dini se unë kam më shumë të drejtë mbi ju sesa vetë ju mbi vetet tuaja?"

Ata thanë: 'Po, ke thënë të vërtetën, o i Dërguari i Allahut.'

Pastaj ai mori dorën e Aliut, e ngriti dhe tha: *"Kujt i kam qenë unë udhëheqës, ky është udhëheqësi i tij. Allahu e do atë që e do atë dhe e armiqëson atë që e armiqëson atë."*²⁶
(<https://forums.alkafeel.net/>)

8-Transmetohet nga Aishe bintu Sa'd, nga Sa'di, se ka thënë: Ishim me të Dërguarin e Allahut në rrugën e Mekës, ndërsa ai ishte drejtuar për atje. Kur arriti në Gadijr Khumm, që ndodhet në Khum, njerëzit u ndalën. Ai i ktheu ata që kishin kaluar përpara dhe priti ata që kishin mbetur prapa. Kur njerëzit u mbledhën, tha: *"O njerëz, a e kam përcjellë mesazhin?"*

Ata thanë: 'Po.'

Ai tha: *"O Allah, dëshmo."*

Pastaj tha: *"O njerëz, a e kam përcjellë mesazhin?"*

Ata thanë: 'Po.'

Ai tha tri herë: *"O Allah, dëshmo."*

²⁶ "Terxhemetul imam Ali min Tarijkhu Dimashk", vëll. 2, f. 53.

Pastaj tha: *“O njerëz, kush është udhëheqësi juaj?”*

Ata thanë tri herë: ‘Allahu dhe i Dërguari i Tij.’

Pastaj ai mori dorën e Ali ibn Ebi Talibit, e ngriti dhe tha: *“Kushdo që ka Allahun dhe të Dërguarin e Tij si udhëheqës, atëherë ky është udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe bëhu armik i atij që e armiqëson atë.”*²⁷ (<https://forums.alkafeel.net/>)

9- Transmetoi Uthman ibn Sa’id nga Sherijk ibn Abdullah, i cili tha: Kur Aliut i erdhi lajmi se njerëzit po e akuzonin për atë që përmendte rreth paraprirjes dhe epërsisë që Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i kishte dhënë atij mbi njerëzit, Aliu tha: *“Për hir të Allahut, kush ka mbetur prej atyre që e kanë takuar të Dërguarin e Allahut dhe e kanë dëgjuar fjalën e tij në ditën e Gadjir Khummit, le të ngrihet dhe të dëshmojë për atë që ka dëgjuar.”*

Atëherë u ngritën gjashtë prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut që ishin në të djathtën e tij dhe gjashtë prej sahabëve që ishin në të majtën e tij. Ata dëshmuan se e kishin dëgjuar të Dërguarin e Allahut atë ditë, teksa ngrinte duart e Aliut, duke thënë: *“Kujt i kam qenë unë udhëheqës, ky Ali është udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik i atij që e do atë, bëhu armik i atij që e armiqëson atë, ndihmoje atë që e ndihmon atë,*

²⁷ Sherh Ibn Ebil Hadijd, vëll. 2, f. 287.

poshtëroje atë që e braktis atë, dua je atë që e do atë dhe urreje atë që e urren atë."

Në një vend tjetër të librit *Nehxh*, Ibn Ebi Hadijdi përcjell këtë pjesë shtesë: Edhe Enes ibn Malik ishte në mesin e grupit, por nuk u ngrit. Aliu i tha: "O Enes! Çfarë të pengon të ngrihesh dhe të dëshmosh, ndërkohë që ti ke qenë i pranishëm?"

Enesi tha: 'O Prijësi i besimtarëve, jam plakur dhe kam harruar.'

Aliu tha: "O Allah, nëse ai është gënjeshtar, godite me një njollë të bardhë që as çallma të mos ia mbulojë."

Talha ibn Umejr tha: 'Pasha Allahun, më pas e pashë atë bardhësi tek ai, më të bardhë se sytë e tij.'"²⁸ (<https://forums.alkafeel.net/>)

10- Ai, Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), tha në ditën e Gadijr Khumit: "Kujt i kam qenë unë udhëheqës, Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe bëhu armik i atij që e armiqëson atë."²⁹ (<https://forums.alkafeel.net/>)

11- Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u ngrit duke mbajtur hutbe dhe mori

²⁸ "Sherh Nehxhul Belaga", vëll. 4, f. 4.

²⁹ "Es Saua'ikul Muhrikah", f. 122.

dorën e Ali ibn Ebi Talibit, pastaj tha: “A nuk jam unë më parësor ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetvetes?”
<https://forums.alkafeel.net/>)

Ata thanë: “Po, o i Dërguari i Allahut.”

Ai tha: “Kujt i kam qenë unë udhëheqës, Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe bëhu armik i atij që e armiqëson atë.”³⁰ (<https://forums.alkafeel.net/>)

12- Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij) u tha muslimanëve gjatë kthimit nga Haxhi i Lamtumirës: “Kujt i kam qenë unë udhëheqës, Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe bëhu armik i atij që e armiqëson atë.”³¹ (<https://forums.alkafeel.net/>)

13- Ali ibn Ebi Bekr El Hejthemi ka thënë: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, Muhamedin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), duke thënë në ditën e Gadijr Khummit: “O Allah! Kujtdo që unë jam udhëheqësi i tij, Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah! Dua je atë që e do atë (Aliun), bëhu armik i atij që është armik i tij, ndihmoje atë që e ndihmon atë dhe përkrahe atë që e përkrah atë.”

Burimi:

³⁰ “Tarijkhul Ja’kubij”, vëll. 2, f. 112.

³¹ Përmbledhja e plotë e veprave të Dr. Taha Husejnit, vëllimi i katërt: Kalifët e Drejtë, f. 443.

Transmetuesi: Habesh ibn Xhunade Es Seluli.

Muhaddithi: Ali ibn Ebi Bekr El Hejthemi.

Libri: Mexhma'u Ez Zeua'id, vëll. 9, f. 109.

Gjykimi i hadithit:

“Transmetuesit e tij janë konsideruar të besueshëm (thiqah).” (رجاله وثقوا)

Transmetimi i hadithit (Tekhrijxh):

E ka transmetuar Sulejman Et Tabarani në El-Mu'xhemul Kebijr (nr. 3514), dhe po ashtu Ibn Ebi Asim në Es Sunneh dhe Ibn Kani'u në Mu'xhem Es Sahabe.

Marrë nga: dorar.net

14- Ne po ktheheshim me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) gjatë Haxhit të tij. Në një vend gjatë rrugës ai ndaloj dhe urdhëroi që njerëzit të mblidheshin për namaz. Pastaj e mori për dore Aliun (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe tha: “*A nuk jam unë më i afërt dhe më me të drejtë ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetvetes së tyre?*”

Ata thanë: ‘Po.’

Atëherë ai tha: “Ky është udhëheqësi (ueliu) i atij për të cilin unë jam udhëhqës. O Allah, bëhu mik i atij që e ka mik atë dhe bëhu armik i atij që është armik i tij!”

Transmetuesi: Al Bera’e ibn Azib

Muhaddithi: Muhammad Nasiriddijn El Albani

Burimi: “Sahih Ibn Maxhah”, nr. 94.

Gjykimi i hadithit: Sahih (i saktë).

Et Takhrixh: E ka transmetuar Ibn Majah (nr. 116) dhe Ahmed ibn Hanbel në “Musned” (nr. 18502).

Marrë nga: dorar.net

Vërtetësia e Hadithit të Gadijrit tek Ehli Suneti

Një numër i madh dijetarësh të Ehli Sunetit dhe Xhematit kanë deklaruar se Hadithi i Gadijrit është i saktë. Ndër ta:

1- Ibn Haxher El Askalani ka thënë: “Sa i përket hadithit: ‘Kujtdo që unë jam mevla (udhëheqës, zotëri), Aliu është mevla i tij’, atë e kanë transmetuar Tirmidhiu dhe Nesaiu. Ai ka shumë rrugë transmetimi, madje shumë të shumta. Të gjitha këto rrugë i ka përmbledhur Ibn Ukde në një vepër të veçantë, dhe shumë prej zinxhirëve të tij të transmetimit janë të saktë (sahih) dhe të mirë (hasen).”³²

Gjithashtu, Ibn Haxheri ka thënë, duke komentuar fjalët e autorit të Et-Tehdhib: ‘Them: Autori nuk ka shkuar përtej asaj që ka përmendur Ibn Abdul Berri, dhe ajo që ai ka përmendur është e mjaftueshme. Megjithatë, ai e ka përmendur hadithin e mevlasë vetëm nga disa persona të cilët i ka emërtuar. Ndërsa Ibn Xherir et-Taberiu e ka mbledhur atë në një vepër të veçantë ku përfshihen shumëfish më tepër transmetues sesa ata që janë përmendur. Ai e ka vërtetësuar hadithin, ndërsa Ebu Abbas Ibn Ukde është kujdesur veçanërisht për mbledhjen e

³² “Fet’hul Barij”, Ibn Haxher El Askanij, vëll. 7, f. 61

rrugëve të tij të transmetimit dhe e ka nxjerrë atë nga transmetimi i shtatëdhjetë sahabëve ose edhe më shumë.”³³

Këto deklarata tregojnë se Hadithi i Gadijr Khummit është konsideruar nga shumë dijetarë të mëdhenj sunitë si hadith me transmetime të shumta dhe me zinxhirë të fortë transmetimi.

2- El Axhlunij ka thënë: Hadithi: ‘Kujtdo që unë jam udhëheqës i tij, Aliu është udhëheqësi i tij’ është transmetuar nga Taberaniu, Ahmedi dhe Ed Dijau në librin “El Mukhtarrah”, nga Zejd ibn Erkami, nga Aliu dhe nga tridhjetë sahabë të tjerë, me shtesën: ‘O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe armik i atij që e armiqëson atë.’ Prandaj, ky hadith është mutevatir (i transmetuar nga aq shumë rrugë sa përjashtohet mundësia e trillimit) ose së paku i famshëm (meshhur).”³⁴

3- Vërtetësimi i hadithit nga Dhehebiu. Është transmetuar: Na ka treguar El Mutalib ibn Zijad, nga Abdullah ibn Muhamed ibn Akil, i cili tha: Isha te Xhabiri në shtëpinë e tij, së bashku me Ali ibn Husejnin, Muhamed ibn Hanefijen dhe Ebu Xha’ferrin. Atëherë hyri një burrë nga Iraku dhe tha: ‘Të betohem në Allahun, më trego atë që ke parë dhe dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).’

³³ “Tehdhijb Et Tehdhijb”, Ibn Haxher El Askalanij.

³⁴ “Keshful Khafa”, El Axhlunij, vëll. 2, f. 274, hadithi nr. 2591.

Xhabiri tha: 'Ishim në Xhuhfe, në Gadijr Khum, dhe aty kishte shumë njerëz nga fiset Xhuhejne, Muzejneh dhe Gifar. Atëherë i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij) doli nga një tendë dhe ngriti dorën tri herë. Pastaj e kapi dorën e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe tha: *"Kujtdo që unë jam udhëheqës i tij, Aliu është udhëheqës i tij."*

Pas transmetimit të këtij hadithi, Dhehebiu ka thënë: Ky është një hadith hasen (i mirë) me zinxhir transmetimi shumë të lartë, ndërsa përmbajtja e tij është mutevatire (e transmetuar në mënyrë të shumëfishtë dhe të pakundërshtueshme)."³⁵

4- Ebul Hasan El Hejthemi (ka vdekur në vitin 807 hixhri) Ebul Hasan El Hejthemij ka vërtetësuar shumicën e rrugëve të transmetimit të Hadithit të Gadijrit në veprën e tij *"Mexhmeu Ez Zeuaid"*. Kjo tregon se një numër i konsiderueshëm dijetarësh të Ehli Sunetit e kanë konsideruar Hadithin e Gadijr Humit si hadith të saktë, të fortë dhe me transmetime të shumta.

³⁵ "Sijer A'lam En Nubela" të Shemsuddin Edh Dhehebij, vëll. 8, f. 334.

Teuaturi i hadithit të Gadijrit tek Ehli Suneti

Një numër i madh dijetarësh të Ehli Sunetit kanë pranuar se Hadithi i Gadijrit është *mutevatir* (i transmetuar në mënyrë të shumëfishtë dhe të pakundërshtueshme). Ndër ta janë:

1. Hafiz Dhehebiu

Dhehebiu e ka transmetuar hadithin dhe ka pranuar *tevaturin* e tij. Ai përmend në biografinë e El Mutalib ibn Zijadit: Nga Abdullah ibn Muhamed ibn Akil, i cili ka thënë: 'Isha te Xhabiri në shtëpinë e tij, së bashku me Ali ibn Husejnin, Muhamed ibn Hanefijen dhe Ebu Xha'ferrin. Atëherë hyri një burrë nga Iraku dhe tha: 'Të betohem në Allahun, më trego atë që ke parë dhe dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).'

Xhabiri tha: 'Ishim në El Xhuhfe, në Gadjir Khum, dhe aty gjendej një numër i madh njerëzish nga fiset Xhuhejne, Muzejneh dhe Gifar. Atëherë i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) doli nga një tendë dhe bëri shenjë me dorën e tij tri herë. Pastaj e kapi për dore Aliun (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe tha: "Kujtdo që unë jam udhëheqësi i tij, Aliu është udhëheqësi i tij."'

Pas kësaj, Dhehebiu komentoi: Ky është një hadith hasen (i mirë), me zinxhir transmetimi shumë të lartë, ndërsa teksti (përmbajtja) e tij është *muteuatir*.”³⁶

Ky vlerësim i Dhehebiut konsiderohet një dëshmi e rëndësishme se Hadithi i Gadijr Khumit ka arritur shkallën e *teuaturit* sipas shumë dijetarëve të hadithit.

2- Hafidh Ibn El Xhezerij

Shemsuddin Muhamed ibn Muhamed El Xhezerij Esh Shafi’ij (ka vdekur në vitin 833 h.) është autor i librit “Esna El Metalib fi Menakib Ali ibn Ebi Talib”, i cili është botuar dhe mund të konsultohet në faqen 48. Në këtë vepër ai ka pohuar teuaturin e Hadithit të Gadijrit dhe e ka transmetuar atë përmes tetëdhjetë rrugëve të transmetimit. Pasi përmendi shumë prej rrugëve të Hadithit të Gadijr Khumit, ai tha: Ky hadith është hasen (i mirë) nga kjo rrugë transmetimi dhe sahih (i saktë) nga shumë rrugë të tjera. Ai është *mutevatir* nga Prijësi i besimtarëve, Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Gjithashtu, ai është *muteuatir* edhe nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!). E kanë transmetuar një numër i madh nga një numër i madh njerëzish, dhe nuk merret parasysh

³⁶ “Sijer A’lam En Nubela” i Shemsuddijn Edh Dhehebij, vëll. 8, f. 334.

përpyjekja për ta dobësuar atë nga ata që nuk kanë njohuri të mjaftueshme në këtë shkencë.’

Pastaj, pasi përmendi një numër sahabësh që e kanë transmetuar këtë hadith, ai tha: Ai është transmetuar saktësisht nga një grup i tillë njerëzish, saqë prej lajmit të tyre arrihet bindja e plotë dhe e prerë. Gjithashtu, është vërtetuar se këtë fjalë i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e ka thënë në ditën e Gadjir Khumit.³⁷

Ky vlerësim i Ibn El Xhezerit tregon se ai e konsideronte Hadithin e Gadijrit si një hadith të vërtetuar dhe *muteuatir*, si nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ashtu edhe nga vetë Profeti Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

3. *Xhelaluddijn Es Sujutij Esh Shafi’ij*

Xhelaluddijn Es Sujutij e ka përmendur Hadithin e Gadijrit ndër hadithet *mutevatire* në veprat e tij:

a- “El Feuaidul Mutekathire fi’l Akhbar El Muteuatire”

b- “El Ez’har El Mutenathire fi’l Akhbar El Muteuatire”

³⁷ “Esna El Metalib fi Menakib Ali ibn Ebi Talib”, f. 3–4.

Fjalët e Sujutit mbi teuaturin e këtij hadithi i kanë përcjellë:

- Abdurrauf El Menauij në veprën e tij “Sherh El Xhami’u Es Sagijr, vëll. 2, f. 442.

- Ali El Azizi në “Sherh El Xhami’u Es Sagijr”, vëll. 3, f. 360.

4. El Axhlunij mbi teuaturin e hadithit

El Axhluni ka thënë: Hadithi: “Kujtdo që unë jam udhëheqësi i tij, Aliu është udhëheqësi i tij”, është transmetuar nga Taberaniu, Ahmedi dhe Ed Dijau në “El Mukhtarah”, nga Zejd ibn Erkami, nga Aliu dhe nga tridhjetë sahabë të tjerë, me formulimin: “O Allah! Dua je atë që e do atë dhe bëhu armik i atij që e armiqëson atë.” Prandaj, ky hadith është muteuatir ose së paku i famshëm (meshhur).³⁸

Ky vlerësim tregon se edhe El-Axhluni e konsideronte Hadithin e Gadijr Humit si hadith me transmetime aq të shumta sa arrijnë shkallën e *tevaturit*, ose të paktën shkallën e hadithit të njohur gjerësisht (meshhur).

³⁸ “Keshf el-Hafa “, i Ismail El Axhlunij, vëll. 2, f. 274, hadithi nr. 2591.

5- Mulla Ali El Kariju El Hanefij

Në librin e tij *“Mirkatul Mefatih Sherh Mishkatil Mesabih”*, pasi përmend disa transmetime të Hadithit të Gadijr Khumit, ai thotë: ‘Përfundimisht, ky është një hadith i saktë dhe nuk ka asnjë dyshim në të. Madje, disa hafizë të hadithit e kanë konsideruar atë *muteuatir*, sepse në një transmetim të Ahmedit thuhet se tridhjetë sahabë e dëgjuan atë nga Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe dëshmuan për të në favor të Aliut kur ai u kundërshtua gjatë ditëve të hilafetit të tij.’³⁹

6- Xhemaluddin Ataullah ibn Fadlullah Esh Shirazi

Në librin e tij *“El Erbein”* (dorëshkrim), ai thotë: ‘Vetë themeli i këtij hadithi, pa përfshirë tregimin e Harithit, është muteuatir nga Prijësi i besimtarëve Aliu (Paqja qoftë mbi të!), dhe po ashtu është *mutevatir* edhe nga Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Atë e kanë transmetuar një numër i madh dhe turma të shumta sahabësh.’⁴⁰

³⁹ “Mirkatul Mefatih Sherh Mishkatil Mesabih”, vëll. 5, f. 568.

⁴⁰ Shih: “Nefehatul Ez’har fi Khulasat Abekatil Enuar”, vëll. 6, f. 113.

7- El Menauij Esh Shafi'ij

Edhe Abdurrauf El Menauij në librin e tij *“Et Tejsir”* e ka përmendur Hadithin e Gadijrit ndër hadithet me transmetim të fortë dhe të njohur.

8- Mirza Mahdum ibn Mir Abdul-Baki

Në librin e tij *“Neuakid Err Rreuafid”*, ai thotë: ‘Nëse më pyet për Hadithin *mutevatir* të Gadijrit, do të të paraqes përmbledhjen e tij.’⁴¹

9- Muhamed ibn Ismail Es San'anij El Jemenij

Në librin e tij *“Er Reudah En Nedijje”*, ai thotë: ‘Meqenëse imamët e hadithit e kanë pranuar me drejtësi *teuaturin* e tij, ne nuk do të zgjatemi duke përmendur të gjitha rrugët e transmetimit, por do të përmendim disa prej tyre për bereqet.’⁴²

⁴¹ “Nefehatul Ez’har fi Khulasat Abekatil Enuar”, vëll. 6, f. 112.

⁴² (Shih: “Ihkakul Hakki”, vëll. 6, f. 294; si dhe “Nefehatul Ez’har fi Khulasat Abekatil Enuar”, vëll. 6, f. 116.

10- Muhamed Sadr Alem

Në librin e tij *“Me’arixhul Ula”* ai thotë: Dije se Hadithi i Mevlasë (udhëheqësisë) është muteuatir sipas Sujutiut (Allahu e mëshiroftë!) siç e ka përmendur në *“Katful Ez’har”*. Prandaj desha të paraqes rrugët e transmetimit të tij që *tevaturi* të bëhet edhe më i qartë.”⁴³

11- Shejkh Abdullah Esh Shafi’ij

Në librin e tij *“El Erbein”*, si dhe në librin *“El Menakib”*, f. 108 (dorëshkrim), ai ka thënë: Ky lajm (pra Hadithi i Gadijrit) e ka tejkaluar kufirin e *teuaturit*. Nuk ekziston pothuajse asnjë transmetim tjetër që është përcjellë përmes rrugëve të tilla të shumta si këto rrugë transmetimi...’ (Kjo është cituar në veprën *“Ihkakul Hakki”*, vëll. 6, f. 290.)

12- Shejh Dijauddin El Mukbilij

Në librin e tij *“El Ebhath El Museddede fil Fununil Muteaddi”* ai ka thënë: ‘Ndër dëshmitë për këtë është ajo që është transmetuar në lidhje me Aliun (Allahu e nderoftë fytyrën e tij në Xhenet!). Kjo çështje, në tërësinë e saj, është *muteuatire* në kuptim. Ndër transmetimet më të qarta në

⁴³ “Nefehatul Ez’har fi Khulasat Abekatil Enuar”, vëll. 6, f. 116.

domethënie dhe më të njohura në transmetim është hadithi:
“Kujtdo që unë jam udhëheqësi i tij, Aliu është udhëheqësi i tij.”

Në disa transmetime shtohet: “O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe armik i atij që e armiqëson atë.”

Ndërsa në disa transmetime të tjera shtohet:
‘Ndhimjo atë që e ndihmon dhe poshtëroje atë që e braktis.’

Rrugët e transmetimit të këtij hadithi janë shumë të shumta. Për këtë arsye, disa dijetarë kanë arritur në përfundimin se ai është *muteuatir* edhe në vetë formulimin e tij, e jo vetëm në kuptim...’

Pastaj ai shton: ‘Po, nëse një transmetim i tillë nuk konsiderohet i njohur me siguri, atëherë nuk ka asgjë të njohur me siguri në këtë botë.’⁴⁴

13- Kadi Thenaullah Panipati

Një nga dijetarët e njohur të Indisë, Thenaullah Panipati, ka thënë: Ky hadith është i saktë, madje *muteuatir*. Atë e kanë transmetuar tridhjetë sahabë... dhe shumica e dijetarëve të hadithit e kanë përmendur në librat e haditheve të sakta (sihah), në sunene dhe në musnede.’⁴⁵

⁴⁴ “Nefehatul Ez’har fi Khulasat Abekatil Enuar”, vëll. 6, f. 115–116.

⁴⁵ “Nefehatul Ez’har fi Khulasat Abekatil Enuar”, vëll. 6, f. 117–118.

14- Muhamed Nasiruddin El Albani

Në librin e tij *“Silsiletul Ehadith Es Sahiha”*, pasi numëroi rrugët e ndryshme të transmetimit të Hadithit të Gadijr Khumit dhe thënies së Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): *“Kujtdo që unë jam udhëheqës i tij, Aliu është udhëheqës i tij. O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe armik i atij që e armiqëson atë.”*, dhe pasi i vlerësoi si të sakta shumicën e tyre, ai tha: Hadithi ka edhe shumë rrugë të tjera transmetimi. Një numër të madh prej tyre i ka mbledhur El Hejthemi në *“Mexhmeu Ez Zeuaid”*, vëll. 9, f. 103–108. Unë kam përmendur dhe analizuar aq sa kam mundur prej tyre, në mënyrë që kushdo që i shqyrton ato dhe studimin e zinxhirëve të tyre të arrijë me bindje të plotë në saktësinë e hadithit. Përndryshe, rrugët e tij janë shumë të shumta. Ibn Ukde i ka përmbledhur ato në një libër të veçantë. Hafiz Ibn Haxheri ka thënë: ‘Disa prej tyre janë sahih (të sakta) dhe disa hasen (të mira).’

Pastaj ai vazhdon: Përfundimisht, hadithi në fjalë, domethënë: *“Kujtdo që unë jam udhëheqës i tij, Aliu është udhëheqës i tij. O Allah, bëhu mik i atij që e do atë dhe armik i atij që e armiqëson atë”*, është një hadith i saktë në të dy pjesët e tij. Madje, pjesa e parë e tij është mutevatire nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), siç bëhet e qartë për këdo që ndjek rrugët dhe zinxhirët e transmetimit të tij. Ajo që kam përmendur unë është vetëm një pjesë e vogël e tyre.”

Më pas ai shton: Arsyeja që më shtyu të shkruaj hollësisht për këtë hadith dhe të sqaroj saktësinë e tij ishte se pashë që Ibn Tejmije e kishte konsideruar të dobët pjesën e parë të hadithit, ndërsa për pjesën e dytë kishte pretenduar se është e trilluar (e pavërtetë)!⁴⁶

El Albani komenton: 'Kjo është një nga teprimet e tij, e cila, sipas vlerësimit tim, ka ardhur si rezultat i nxitimit në dobësimin e haditheve para se t'i mblidhte të gjitha rrugët e transmetimit dhe t'i studionte ato me kujdes. Allahut i kërkohet ndihma.'⁴⁷

⁴⁶ "Mexhmu'ul Fetaua", vëll. 4, f. 417–418.

⁴⁷ "Silsiletul Ehadith Es Sahiha", vëll. 4, f. 343–344, botimi i Riadit.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
Çfarë është Dita e Gadijrit?	9
Festa e Gadijrit	11
Arsyeja e emërimit me emrin “Gadijr”	12
Pse Dita e Gadijrit u bë festë?	12
Festa e Gadijrit – Dita e Plotësimit të fesë dhe e përmbushjes së mirësisë.....	14
Festa e Gadijrit – Festa më e madhe dhe më e nderuar .	17
Nuk ka justifikim për askënd	20
Festa e gadijrit në Islam	22
Çështja e parë:	23
Çështja e dytë:	28
Hadithi i urimit të imam Aliut pas caktimit.....	31
Hadithi i Gadijrit në burimet e Ehli Sunetit	62
Vërtetësia e Hadithit të Gadijrit tek Ehli Suneti.....	71
Teuaturi i hadithit të Gadijrit tek Ehli Suneti.....	74
1. Hafiz Dhehebiu	74
2- Hafidh Ibn El Xhezerij	75

3. Xhelaluddijn Es Sujutij Esh Shafi'ij	76
4. El Axhlunij mbi teuaturin e hadithit.....	77
5- Mulla Ali El Kariju El Hanefij.....	78
6- Xhemaluddin Ataullah ibn Fadlullah Esh Shirazi..	78
7- El Menauij Esh Shafi'ij	79
8- Mirza Mahdum ibn Mir Abdul-Baki	79
9- Muhamed ibn Ismail Es San'anij El Jemenij	79
10- Muhamed Sadr Alem.....	80
11- Shejkh Abdullah Esh Shafi'ij.....	80
12- Shejh Dijauddin El Mukbilij.....	80
13- Kadi Thenauallah Panipati	81
14- Muhamed Nasiruddin El Albani	82

إسم الكتاب: ما هو يوم الغدير

الاعداد: الحاج الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي: زهراء مريا

التصحيح اللغوي: إسراء مريا

الإخراج النهائي: صرييه فزا

الغلاف: صرييه فزا

الناشر: جمعية النسيم

تيرانا- البانيا- 2026